

Rrugat Arbërit

AURORA GROUP
PROJEKTIM - ZBATIM
Qoha kalon, cilësia mbetet
Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

GAZETË E PAVARUR. NR. 9 (41). SHTATOR 2009. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO

AKTUALITET

Termeti, 600 shtëpi bëhen të pabanueshme

Qeveria vendos: 130 milionë lekë për 1437 banesa të dëmtuara në qarkun e Dibrës

FAQE 3

REPORTAZH

Luginës së Tujanit

Nga: **SHAQIR SKARRA** - FAQE 7



PORTRET

Homazh për Bajram Matën

Nga: **XHAFER MARTINI** - FAQE 14

OPINION

Tërmeti që gjunjëzoi mistrinë dibrane

Nga: Prof. Asc. Sazan GURI

Vazhdoj të këmbëngul që tërmetet, vullkanet, tornadot, cunamet nuk janë fatkeqësi natyrore, përpos vlerave dhe dobive, që ato i sjellin njerëzimit, tokës dhe vetë jetës (shkrimi i kaluar ndalet më gjatë në këtë veti). Por, nuk qenka e thënë, që ajo të jetë vlerë dhe dobi për Shqipërinë dhe shqiptarët, megjithëse praktikisht me të janë qysh në kohën e të parëve tanë pellazgë, që e kanë pagëzuar me emrin terr – tokë e thatë (terr rrobat – thaj rrobat), dhe më vonë latinët i shtuan fjalën lëviz-motion, prej nga u formatua termi koncept terra moto, shqip tërmet.

Dihet se tërmetet apo vullkanet janë po aq të vjetër sa toka, qysh 4,5 miliardë vjet, duke i dhënë kuptim, moshë deri në jetë, jetës në tokë. Aq të lidhur janë këto dukuri me tokën, sa nëse pushon së ekzistuar njeri prej tyre merr fund tjetri. Pra, për sa kohë do të ketë jetë mbi tokë aq do të ketë dhe tërmete apo vullkane. Njeriu, qysh në fillimet e veta prej një milion vjetësh, ose prej 26 sekondash nëse tokat matet e tëra me 12 orë jetë, i gjeti tërmetet dhe për sa kohë nuk i njihje, ai trembej sikundër nga bubullimat e vetëtimat. Dhe kjo nuk zgjati pak, por fiks një milion vjet pa mijëvjeçarit e fundit, kur ai filloi ta njihje si forcë normale të natyrës dhe falë kërkimeve gjeologjike, ai (njeriu) filloi të shpjegonte shkaqet e tij, vendet e ndodhjes e çdo gjë tjetër me përgjithësi të kohës se kur ndodh dhe sidomos njëqindvjeçarit e fundit ai filloi ta hartografonte atë, duke kaluar nga faza pagane e tromaksjes prej tij në atë shkencore e praktike të menaxhimit të tij. Siç e thamë dhe në një shkrim të mëparshëm ka qenë kjo dukuri, e cila ka bërë, që njeriu të shkëputet përfundimisht nga bashkëjetesa me shpellat, duke zhvilluar shkencat e ndërtimit, të arkitekturës, të bazamenteve gjeologjike të tokës, etj.

(Vijon në faqen 2)

Detajet e projektit nga Bulqiza në Tiranë



Subvencionet bujqësore, investime të suksesshme

Nga: **DALI HOESHKA** - FAQE 6

PROFIL

Mati nuk mund ta harrojë Mynir Shehun

Nga: **HAMDI HYSUKA** - FAQE 15

KRIKË LETRARE

Ujëvara e metaforave...

Nga: **QERAM CIBAKU** - FAQE 11

Flet Dr. Ing. **FARUK KABA**:

Qafa e Murrizës do të kalohej me një tunel rreth 3.5 km të gjatë dhe më pas një tunel në afërsi të Gurit të Bardhë me gjatësi rreth 0.6 km. Një urë e pandërtuar ndonjëherë në vendin tonë, me gjatësi rreth 300 metra, do të ndërtohet mbi Urën e Vashës. Rruga do të ketë edhe një sërë veprash të tjera, tre viadukte me lartësi mbi 20-25 metra secili, dhjetëra ura të tjera më të vogla, mure në formën e "terra armata", një teknologji e veçantë kjo për urat e këtyre madhësive e të tjera vepra më të vogla. Rruga do të jetë e asfaltuar me gjerësi 9 metra të asfaltit dhe dy bankina të paasfaltuara nga 1 metër. Shpejtësia e lëvizjes do të jetë 80 deri 100 kilometra në orë, pasi e gjithë rruga do të shoqërohet me një sinjalistikë moderne bashkëkohore.

(LEXONI NE FAQEN 5)

Jeraldine Center
Kurse Gjuhesh dhe Kompiuteri
Aftesim Profesional
Qendra Xheraldine
FILLUAN REGJISTRIMET

Adresa:
Rr. Durresit,
Kompleksi Ginatsh
dhe Pall. HAWAI,
Kulla 3, Kati II.
LAPRAKE, Tiranë.
Mob. 0692139257
0683729582
Tel: (04) 2 400 656

Tërmeti në Dibër tronditi jo vetëm themelet e shtëpive, por edhe dëshirën e njerëzve për të ndërtuar të ardhmen...

e ditës

Posta e Rruga Arbërit


Gazetë e pavarur.
Nr. 9 (41). 1- 30 Shtator 2009

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Isa Halilaj, Mahmud Hysa, Xhafer Martini, Rexhep Ndreu, Haki Kola, Xhelal Roçi, Beqir Sina, Odise Plaku, Rexhep Torte, Kujtim Boriçi, Dukagjin Hata, etj, se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër. Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës. Shkrimet priten në redaksi deri më datë 20 të muajit. Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi. Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

Këshilli Botues:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Bashkëpunuan në këtë numër:
Sazan GURI
Hamdi HYSUKA
Rexhep TORTE
Xhafer MARTINI
Qeram CIBAKU
Dali HORESHKA
Abdurahim ASHIKU
Moisi MURRA
Selman MEZIU
Hysen UKA
Mevlud BUCI
etj.

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. + 355 4 22 33 283
E-mail: rrugaarbërit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Dibër e Madhe, tërmet i fuqishëm, por pa viktima

Ministri Xhelil Bajrami vizitoi Dibrën e Madhe

Në ora 23 e 49 minuta të datës 6 gusht Dibrën e Madhe e goditi një tërmet i fuqishëm prej 7 ballë, epiqendra e të cilit ishte në Gjoricë të Shqipërisë që ndodhet 4 km larg Dibrës së Madhe. Lëkundjet e tokës vazhduan gjatë tërë natës dhe po vazhdojnë ende. Kjo i detyroi dibranët që tërë natën ta kalojnë në ankth dhe nën qiell të hapur.

Argëtim Fida, kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe dhe bashkëpunëtorët e tij tërë natën patën kontakte me Kryeministrinë, zv. kryeministrin Abdulaqim Ademin, policinë e Dibrës, spitalin, zjarrfikësit dhe qytetarët. Për fat të mirë përveç plasaritjeve nëpër shtëpi e banesa dhe ndonjë muri të rrëzuar, të plagosur dhe viktima nuk pati.

Me këtë rast Dibrën e Madhe e vizitoi edhe Xhelil Bajrami, ministër për Punë dhe Çështje Sociale, i dërguar i Qeverisë së Maqedonisë për tu njohur me gjendjen pas këtij



tërmeti të fuqishëm. Ai para gazetarëve deklaroi se: "Qeveria me të mësuar se Dibra është goditur nga tërmeti, më dërgoi të vij të njihem me dëmet e shkaktuara nga ky tërmet. Qeveria do të jetë gjithnjë pranë di-

branëve dhe kudo që do të ndodhin fatkeqësi. Unë vizitova disa shtëpi të dëmtuara dhe pas marrjes së të dhënave nga Komisioni Komunal për vlerësimin e dëmeve, do të ndërmarim hapat e mëtutjeshëm për ko-

mpensimin e dëmeve".

Argëtim Fida në këtë rast falënderoi Qeverinë dhe ministrin Bajrami për interesimin e shprehur.

Bajrami dhe Fida shprehën kënaqësinë e tyre që përkundër këtij tërmeti të fuqishëm nuk pati të lënduar ose viktima.

Tërmete me intensitet prej 5,4 dhe 3 ballë po përsëriten në vazhdimësi gjë që e mbajnë në gjendje të frikësuar popullatën e Dibrës së Madhe. Sa herë që ndodhin këto tërmete dibranët largohen nga shtëpitë e tyre. Të përkujtojmë se në nëntor të vitit 1967 Dibrën e goditi një tërmet shumë i fuqishëm që shkaktoi katër viktima dhe rrënimin e shumë objekteve shtëpiake dhe industriale.

Vazhdon puna e komisionit për evidentimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti.

Me afrimin e vjeshtës shtohet edhe më shumë ankthi nga tërmetet sepse qëndrimi eventual nën qiellin e hapur do të jetë shumë i vështirë.

R.Torte

Opinion

Tërmeti që gjunjëzoi mistrinë dibrane

(Vijon nga faqja 1)

Në këtë kuptim, me përjashtim të rasteve kur ai është më i fortë se çka ndodhur më parë, jashtë parashikimit të mundshëm, që njëherësh do të thotë fatkeqësi natyrore, në raste e tjera ai s'është gjë tjetër, veçse një dukuri normale natyrore dhe kur përmban fatkeqësi, ato me plot gojë mund t'i quash fatkeqësi njerëzore ose për shkak të njerëzve.

Këtë kuptim marrin rrëshqitjet me gjithë shtëpi në Kavajë muaj më parë, për shkak të një tërmeti rreth 2,5 të shkallës Rihter ose 4 ballë të shkallës Merakli apo zhytjet e tokës në Zharrës, për shkak të një tërmeti rreth 1,5 të shkallës Rihter ose 2-3 ballë të shkallës Merkal apo mbi të gjitha shembjet e ditëve të fundit, jo pak, të 1200 shtëpive në Dibër, për shkak të një tërmeti rreth 5,2 të shkallës Rihter ose 7 ballë të shkallës Merakli, kur dihet që tërmetet sot në botë mund të fillojnë të çajnë e të shembin ndërtime, kur janë mbi 6,2 ballë të shkallës Rihter ose 8 ballë të shkallës Merkal. Kësaj, kemi për hise të themi, që më thuaj se në ç'ballë të fillojnë të bien ndërtimet të të them se çfarë Shteti je, çfarë Qeverie mban, çfarë shkence bën, çfarë ndërtuesish ke dhe së fundi sa të përgjegjshëm qytetarët i ke. Pikërisht, sot, nuk po arrihet as niveli i intuitës popullore arkitekti i kohëve të Mesjetës apo të eksperiencës popullore, ku qëmoti shtëpitë ndërtoheshin ose të lehta (kallama e rrogoza), sigurisht pa lezet ose mbi faqe shkëmbore plot shëndet, si Berati Mangalem, Gjirokastra Dunavat, Kruja, etj.

Gjithmonë kam marrë penën e të shkruaj në mbrojtje të jetës apo të anës së qytetarit, por zanati dhe profesioni nuk më lënë pa thënë dy fjalë për dibranin, që ndërtoi shtëpi e komplekse shtëpish anëmbanë vendit, pas tërmeteve të Shkodrës (Bahçallëk, 1979), pas tërmeteve të Fier-Lushnjës (1959).

Si mund të shkatërrohen këto shtëpi në Dibër, që Zoti boll i ka ndihmuar, duke i falur një faqe kodrinore me shkëmbinj, që të paktën e zbusin një shkallë apo një ballë tërmetin. Si mund të shemben shtëpi, që Zoti boll i ka ofruar një lumë për rërë e llaç apo i ka ofruar male për gurë apo i ka ofruar pyje për lëndë drusore...

Zanati dhe profesioni më shtynjë që të thërras mendjen dibrane, atë mendje që lind në Shkodër, pushon apo llogjikoset në Mirditë dhe së fundi vishet si një nuse apo dhëndër i bukur në Dibër, por jo këtë të sotme, që një shkundje e tokës në nivelet që njeriu sot i komandon, t'i trazojë jetën e vet dhe më tepër të fëmijëve të vet, por të pafajshëm. Gjithkush mund edhe të qortojë, se një popull nuk shahet. E dua Platonin, mësuesin tim të madh, thoshte një filozof i lashtë pellazg, por dua më shumë të vërtetën. Ndaj edhe unë, e dua popullin tim, si djali-babanë, e dua dibranin si vëllai-vëllanë, por më shumë dua zanatin dhe profesionin tim, që më ka mësuar si të parashikojë atë që mund të ndodhë, që më ka përgatitur si të zbusë pasojat kur ajo ndodh, që më ka pajisur me atë shkencë që të bëjë që më ky dëm mos të ndodh. Dua zanatin dhe profesionin tim, që në këtë rast nuk më lejon të thur epos për dibranët, sepse më duken të mjerë, që në këtë rast nuk më lejon të vazhdoj të ngre lavde për mistrinë e tyre, për atë mistri që ka bërë kala nëpër Shqipëri e Ball-



kan dhe bën hata në shtëpinë e tyre, për atë mistri që ka ndërtuar e mirëmbajtur në shekuj rrugët e lidhjes së kulturave Greko-Romake (Egnatia – eg'jata), besimeve Romë-Stamboll (rruga e Arbrit) deri në rrugët e ditëve të sotme, ku 70% e punëtorëve të firmës "Granit" në veprat ndërtimore në Moskë janë me origjinë Dibrane, ku dhe autori i këtyre rreshtave ka ndërjet tisin e shijeve dhe elegancën ndërtuese të dibranëve në shtëpinë e fëmijërisë së vet të rrëzuar në Mangalem të Beratit, ku babai kërkonte pa një pa dy, dorën dibrane që të mos i trembesh më ndonjë rrokullisje tjetër shkëmbi nga faqja e malit kala.

Por, shqetësimi qëndron në atë, se si mund të çahet një shtëpi tej e përtej në gjithë lartësinë e saj, ose të bjerë vetëm suvaja apo të shkasin pjesë të çatisë ose të ndahet pikërisht, atje, ku bashkohen muret? Si mund të shkatërrohen këto shtëpi në Dibër, që Zoti boll i ka ndihmuar, duke i falur një faqe kodrinore me shkëmbinj, që të paktën e zbusin një shkallë apo një ballë tërmetin. Si mund të shemben shtëpi, që Zoti boll i ka ofruar një lumë për rërë e llaç apo i ka ofruar male për gurë (Gjuric – gurë, guriçka, zhurre) apo i ka

ofruar pyje për lëndë drusore (Shupenzë – shumë pyje ose shumë pemë). Po sepse, shtëpia nuk kishte një brez betoni ose të paktën një brez me dru, që të ndajë rezonancat e valës së tërmeteve përgjatë lëkundjeve. Po sepse, shtëpia nuk kishte një gur qosheje, që të lidhte muret apo një arkitra që të lidhte dritaret. Po sepse, shtëpia nuk kishte themele me gurë që muret të inkastrohen e të lidhen me shkëmbin apo çati me trarë të gozhdur që mund të fluturojë nëse e gjithë shtëpia shket e ikën e tëra për lësh. Hej dibranë ustallarë apo shqiptarë pashallarë! Kujdes?! Po atij në Venezuelë, ku toka i ofron dhe e rrethon vetëm me ujë deti apo oqeani dhe tërmeti për fat të keq i bie edhe më i fortë se sa tek ju, pikërisht si këto ditë, 6,5 të shkallës Rihter ose 8,2 ballë Merkali, i bie të zhduket me farë e me fis?

Ndaj dhe shprehim këtë qejfmbetje me dibranët, ku tërmeti i turpëroi mendjen, plasja e shtëpive i nxori të palartat dhe rrëzimi i shtëpive i gjunjëzoi mistrinë. Por, kjo nuk është dhe nuk lidhet vetëm me dibranët. Dje me Kavajën, sot me Dibranët, nesër me Golemin, pasnesër me Tiranën, pse jo, pas pasnesër me gjithë Shqipërinë.

Prof. Asc. Sazan GURI

Rreth 588 shtëpi dhe rreth 10 objekte social-kulturore, shkolla etj., janë të pabanueshme dhe të pashfrytëzueshme, si dhe rreth 3000 shtëpi të tjera që kanë dëmtime të vogla, të cilat kanë nevojë për riparime.

Termeti, 600 shtëpi bëhen të pabanueshme

Qeveria vendos: 130 milionë lekë për 1437 banesa të dëmtuara në qarkun e Dibrës

Tërmeti i datës 6 shtator në mesnatë ka tronditur themelet e banesave në Dibër. Janë rreth 588 shtëpi dhe rreth 10 objekte social-kulturore, shkolla etj., që janë të pabanueshme dhe të pashfrytëzueshme si dhe rreth 3000 shtëpi të tjera që kanë dëmtime të vogla, të cilat kanë nevojë për riparime. Këto të dhëna, sipas burimeve nga Prefektura e Dibrës, janë nxjerre nga ekspertët e saj gjatë evidentimeve në terren. "Menjëherë pas rënies së tërmetit, Prefekti i Dibrës z. Xhafer Seiti, ka qenë në terren në komunat Shupenzë e Gjoricë, ku dëmet kanë qenë më të mëdha dhe në bashkëpunim me drejtuesit lokalë ka filluar puna për evidentimin e dëmeve. Po këtë ditë, në Gjoricë ishte edhe Kryeministri z. Sali Berisha, i cili në takimin me drejtues të qeverisjes vendore, të Ministrisë së Brendshme, të Institucioneve Qendrore në nivel vendor etj., u informua për situatën e krijuar nga Prefekti i Qarkut, kryetarët e komunave Gjoricë, Shupenzë, Maqellarë, Zerqan, Osten, Trebisht dhe kryetarët e bashkive Peshkopi e Bulqizë.

"Falënderoj zotin që nga tërmeti i fuqishëm 7.2 ballësh me epiqendër në Gjoricë, nuk pati dëme në njerëz, tha në atë takim Kryeministri, dhe se kishte ardhur në vend për të parë e për t'u informuar për pasojat e tërmetit, me qëllim marrjen e masave sa më të shpejta për evitimin e plotë të tyre".

Sipas burimeve nga Prefektura, për evidentimin e dëmeve u ngritën 7 grupe pune që vepruan në fshatrat Shupenzë, Maqellarë, Fushë-Bulqizë, Osten, Muhurr, Trebisht.

Grupet e punës kanë plotësuar dokumentacionin për 104 objekte si dhe kanë vlerësuar dëmet e shkaktuara për 1155 objekte të tjera.

Tërmeti i shtatorit ishte vetëm një javë para se arsimit i detyrueshëm të hapte tiparin për këtë vit, por burimet e mësipërme thanë se "më 14 shtator 2009, mësimet kanë filluar



normalisht në të gjitha shkollat e zonave të prekura nga tërmeti". Mësimet janë shtyrë në vetëm në disa shkolla, ku nuk kanë përfunduar punimet e rikonstruktimit të tyre, të nisura kohë më parë, si në shkollën 9-vjeçare Kuben, komuna Kastriot, rrethi Dibër për 2 javë, në shkollën 9-vjeçare Fushë-Bulqizë 2 javë dhe në shkollën e mesme të bashkuar Suç, të rrethit Mat, 2 ditë.

Emergjencia e parë për banorët e këtyre zonave kanë qenë paisja me çadra dhe shpërndarje me ushqime, megjithëse banorët e zonave të prekura kanë qenë shumë të pakënaqur nga ky proces. Mediat qendrore kanë raportuar çdo ditë nga terreni, por edhe drejtpërdrejt, ku një pjesë e banorëve e kanë gdhirë jashtë, megjithë kushtet e motit të paqëndrueshme.

Sipas prefekturës, janë shpërndarë më shumë se 7 ton ushqime si dhe materiale të tjera si çadra, batanije etj.

Por, vendimi më i rëndësishëm ishte më datë 30 shtator, kur me një

Nga verifikimet e bëra rezultojnë të jenë 1437 banesa të dëmtuara, me një vlerë dëmsh të llogaritur në mbi 129.359.122 lekë. Vlerësimi është bërë në bazë të çmimeve të miratuara për këtë qark, nga Enti Kombëtar i Banesave. Një pjesë e fondit do të përballohet nga Ministria e Brendshme në zërin "Emergjencat Civile", ndërsa pjesa tjetër do të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2009.

vendim të posaçëm të qeverisë, është vendosur kompensimi i familjeve të dëmtuara nga tërmeti.

Në mbledhjen e Këshillit të Ministrave u miratua vendimi "Për miratimin e vlerës së dëmeve të shkaktuara në objektet, në pronë private, si rrjedhojë e tërmetit rënë në qarkun e Dibrës, dhe të listave emërore me vlerat përfituese". Ky projektvendim ka për qëllim miratimin e vlerës së dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 7 shtator 2009, në qarkun e Dibrës, vlerësimi i të cilave është bërë në bazë të çmimeve të miratuara për këtë qark, nga Enti Kombëtar i Banesave. Nga verifikimet e bëra rezultojnë të jenë 1437 banesa të dëmtuara, me një vlerë dëmsh të llogaritur në mbi 129.359.122 lekë. Në këtë vendim është parashikuar që një pjesë e fondit të përballohet nga Ministria e Brendshme në zërin "Emergjencat Civile", ndërsa pjesa tjetër do të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2009.

SHTËPI DHE OBJEKTE TË PABANUESHME

Gjoricë: 64 shtëpi, 2 shkolla
Shupenzë: 15 shtëpi, 3 shkolla
Zerqan: 109 shtëpi, 1 qendër shëndetësore, 1 kopësh
Ostren: 2 shtëpi të shembura, 15 dëmtuar rëndë, 1 shkollë
Maqellarë: 65 shtëpi
Fushë-Bulqizë: 6 shtëpi
Melan: 27
Trebisht: 20 shtëpi, 2 kabina efekt.
Koms: 21 shtëpi
Lis: 1 shtëpi
Suç: 10 shtëpi
Rukaj: 8 shtëpi
Zall-Dardhë: 1 shtëpi
Selisht: 1 shtëpi
Muhurr: 3 shtëpi
Derjan: 1 shtëpi shemb, 4 shtëpi, 1 objekt social
Luzni: 80 shtëpi
Gjithsej 598 shtëpi e objekte



SHTËPI ME DËMTIME MESATARE DHE TË LEHTA

Gjoricë: 216 shtëpi
Shupenzë: 900 shtëpi
Zerqan: 554 shtëpi
Ostren: 2 shkolla, 3 kabina elektrike
Maqellarë: 244 shtëpi
Fushë - Bulqizë: 142 shtëpi
Melan: 30 shtëpi
Trebisht: 155 shtëpi, 2 kabina efekt. 3 objekt soc
Burrel: 12 shtëpi
Klos: 110 shtëpi
Koms: 38 shtëpi
Lis: 11 shtëpi
Suç: 2 shtëpi
Macukull: 12 shtëpi
Rukaj: 1 shtëpi
Zall Dardhë: 24 shtëpi
Zall-Rec: 11 shtëpi
Selisht: 13 shtëpi
Muhurr: 16 shtëpi
Qendër Tomini: 13 shtëpi
Arras: 24 shtëpi, 1 kabinë elektrike.
Derjan: 8 shtëpi
Luzni: 350 shtëpi
Kastriot: 31 shtëpi
Martanesh: 35 shtëpi
Peshkopi: 38 shtëpi
Gjithsej: 3001 shtëpi

Burimi: Prefektura Dibër

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E VLERËS SË DËMEVE TË SHKAKTUARA NË OBJEKTE, PRONË PRIVATE, SI RRJEDHOJË E TËRMETIT, RËNË NË QARKUN E DIBRËS, DHE TË LISTAVE EMËRORE, ME VLERAT PËRFITUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "dh", të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001, "Për emergjencat civile", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Miratimin e vlerës së dëmeve të shkaktuara në objekte, pronë private, si rrjedhojë e tërmetit, rënë në qarkun e Dibrës, në shumën 129 359 122 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet e dy) lekë, të përcaktuar në fund të përmbledhëses, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Miratimin e listave, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me emrat dhe shumat përkatëse të kompensimit, si rezultat i procesit të vlerësimit.
- Fondi, prej 129 359 122 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet e dy) lekësh, të përballohet, si më poshtë vijon:
 - 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Brendshme;
 - 29 359 122 (njëzet e nëntë milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet e dy) lekë, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
- Kryerja e pagesave personave përfitues të bëhet nga këshilli i qarkut Dibër.
- Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme dhe këshilli i qarkut Dibër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
SALI BERISHA**



“Shtrembërimi i fakteve historike dhe i trojeve shqiptare nuk është gjë tjetër veçse tentim i përvetësimit dhe i vjedhjes së tapive shqiptare për trojet etnike ku jetojnë den baba den.”

Enciklopedia Maqedonase vjedh tapitë shqiptare

Nga: REXHEP TORTE

Top-temë e këtyre ditëve në Maqedoni dhe më gjerë duke mos përfshirë Brukselin dhe Uashingtonin është botimi skandaloz i enciklopedisë Maqedonase, ku në mënyrë flagrante shtrembërohet historia e shqiptarëve dhe fyhet populli shqiptar.

Atë çka mund ta bëjë një i çmendur nuk mund ta ndreqin qindra të mençur, - thotë një shprehje popullore.

Akademiku Blazhe Ristovski, albanofobi i dëshmuar i Maqedonisë, nën drejtimin e të cilit u botua kjo enciklopedi kontestuese, edhe njëherë dëshmoj shovinizmin e tij të skajshëm antishqiptar duke nxitur reagime të gjithanshme.

Është për të ardhur keq që edhe pas 18 vitesh të demokracisë dhe të luftës së drejtë të UÇK-së në vitin 2001 në Maqedoni për të drejtat legjitime të shqiptarëve, sot e kësaj dite ekzistojnë forca të errëta maqedonase antidemokratike dhe luftënxitëse.

As kryetari i shtetit Gjorgje Ivanov dhe as kryeministri Nikolla Gruevski nuk e panë të arsyeshme distancimin e tyre nga kjo enciklopedi kundërtshënës. Kryeministri Gruevski në prononcimet e tij herën e parë u shpreh se kjo punë i takon Akademisë së Shkencave të Maqedonisë si institucion më vete, herën e dytë tha se reagimet kundër botimit të kësaj enciklopedie shkojnë në dëm të sukseseve që ka arritur Maqedonia, herën e tretë gjatë mbledhjes së qeverisur i vënë në shënjestër të kritikave nga ministrat shqiptar në pamundësi të përgjigjeve braktis mbledhjen e qeverisur, dhe herën e katërt duke u prononcuar para gazetarëve kërkoi nga pala shqiptare dialog dhe respekt të ndërsjellë edhe pse në botimin e kësaj enciklopedie shqiptarët nuk janë konsultuar fare. Kjo na bën të dyshojmë se botimi i kësaj enciklopedie nuk është bërë pa dijen e qeverisë, e cila ka financuar 180 mijë euro.

Edhe kësaj here u dëshmuar se provokues të konflikteve ndërnacionale në Maqedoni janë vetë Maqedonasit.

Ndërkaq reagimet e lidërshiptit, të OJQ-ve dhe të intelektualëve shqiptar janë shumë të matura. Themi kësh-tu sepse ky shtrembërim i historisë shqiptare dhe i ofendimit të shqiptarëve lyp një reagim më të fuqishëm të lidërshiptit, OJQ-ve dhe intelektualëve shqiptar. Për ta arritur efektin e duhur nevojitet reagim më i ashpër i shqiptarëve nëpërmjet protestave masive demokratike nëpër të gjitha viset shqiptare duke përfshirë shkollat dhe popullatën derisa të tërhiqet ky botim i Enciklopedisë Maqedonase.

Shtrembërimi i fakteve historike dhe i trojeve shqiptare nuk është gjë tjetër veçse tentim i përvetësimit dhe



“Atë çka mund ta bëjë një i çmendur nuk mund ta ndreqin qindra të mençur”, thotë një shprehje popullore.

i vjedhjes së tapive shqiptare për trojet etnike ku jetojnë den baba den.

Nuk ka fakte historike që shqiptarët ti kenë sulmuar dhe okupuar maqedonasit. Përkundrazi shqiptarët gjithnjë kanë qenë në krah dhe në mbrojtje të maqedonasve, si në Luftën e Ilindenit ku morën pjesë edhe shumë shqiptar, gjë që maqedonasit nuk e përmendin fare, ashtu edhe në Luftën e Dytë Botërore, pas përfundimit të së cilës në shtetin e ri të Maqedonisë partizanët shqiptar u vunë në shënjestër të përdjekjeve, burgosjeve dhe vrasjeve nga UDB-ja.

Shqipëria e sotme si rezultat i

kafshimeve dhe i gllabërimeve të trojeve të saj nga fqinjët sot i ngjan një molle të kafshuar nga të gjitha anët.

Po ta kishin botuar shqiptarët një enciklopedi të këtillë ku do të shantazhoheshin maqedonasit, me siguri autorët shqiptar do të viheshin në goditje të ashpër nga prokuroria, gjyqësia dhe burgosjet, gjë që nuk ka gjasa të ndodhë me këta autorë maqedonas, të cilët me botimin e kësaj enciklopedie shkelën të gjitha parimet e kodeksit etnik dhe të bashkëjetesës.

Kjo enciklopedi e sakatosur dhe e dëmshme duhet tërhequr sa më parë. Edhe një ekzemplar i vetëm në duart e lexuesit do të shkaktonte hamendje për të vërtetën e trojeve shqiptare dhe të shqiptarëve.

Edhe akademitë e shkencave në Tiranë dhe Prishtinë dhe qeveritë e dy vendeve duhet të jenë më energjike ndaj akademisë së Shkencave të Maqedonisë dhe Qeverisë të Maqedonisë lidhur me këto provokime të njëpasnjëshme.



Reagon ashpër Akademia e Shkencave Shqiptaro-Amerikane

Nga: BEQIR SINA, New York

Gati peticioni, ku do të kërkohet të ndalohet botimi dhe publikimi i Enciklopedisë së re maqedonase, dhe heqja e menjëherëshme saj nga qarkullimi

NEW YORK CITY. Duke u solidarizuar me reagimin mbarë shqiptarëve, kudo që janë, edhe Akademia e Shkencave Shqiptaro-Amerikane, me qendër në New-York, thotë se kemi vendosur t'i drejtohem mi me këtë rastë, si qytetar amerikan, në bazë të Amandamentit të Parë të Kushtetutës Amerikane, Departamentit Amerikan të Shtetit, Arkivit të Sigurisë Kombëtare, SHBA, dhe raportit të CIA-së për Maqedoninë. Ne kemi vendosur me këtë rastë, t'i drejtohem SHBA-ës, thuhet në deklaratën e kësaj akademie, si qytetar amerikan.

Kujtojmë, me këtë rastë ceket në deklaratë, se “Amendamenti i Parë i Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mbron të drejtën e lirisë së besimit dhe të lirisë së shprehjes nga ndërhyrja e qeverisë, për çdo qytetar Amerikan. Në këtë kontekst, Amendamenti i Parë i Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, garanton nga ana e saj se “Liria e shprehjes përbëhet nga të drejtat e lirisë së fjalës, shtypit, mbledhjes dhe drejtimit të peticioneve qeverisë, për çdo lloj korrigjimi të ankesave, dhe të drejtat e nënkuptuar të diskreminimit mbi baza racore dhe besimit, të të gjithë qytetarëve Amerikanë.”

Prof. Dr. Skender Kodra PhD. kryetari i Akademisë së Shkencave Shqiptaro-Amerikane, me qendër në New-York, e themeluar 15 vjet më parë, ka reaguar sot ndaj një botimi skandaloz të Enciklopedisë maqedonase, të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, ku përdoren referenca përcmuese dhe fyese, për shqiptarët etnik, si dhe fakte të padëshmuara kurrë, në historinë e këtij vendi.

Në deklaratën e Akademisë së Shkencave Shqiptaro-Amerikane, thotë Prof. Dr. Skender Kodra, kemi theksuar se përdorime të termave të kësaj Enciklopedie, “Shiptars”, “shqiptarët janë njerëz malesh” janë vetëm për llogari të paragjykimave etnike, me doza të pa imagjinueshme fallsifikimesh, sa s’ka as edhe një fije dyshimi, që ato mund të jenë vetëm rezultat i një skenari të parapërgatitur nga akademia e Beogradit në bashkëpunim me Shkupin. Duke kujtuar, edhe një herë ish profesorin serb të Universitetit të Prishtinës, shkrimtarin Vujadin Millanoviq, dhe librin e tij shovinist, të botuar më 1990, në Prishtinë, “Universiteti i Prishtinës në Rrjetin e Shqipërisë, së Madhe”, ku ai i fryn ndjenjave anti shqiptare, me anë të shtrëbrimit të fakteve historike, dhe përdor terma të njësojta, si këto të akademikve maqedonas.

Në deklaratë, mes tjerash thuhet se Akademia e Shkencave Shqiptaro-Amerikane, kishte besuar me të vërtetë, se qëndrimet antishqiptare, të shfaqura më parë, nga një pjesë të Akademisë Maqedonase, dukej se kishin marrë fund, edhe me qëndrimin për largimin në atë kohë të ish Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Maqedonisë Gjeorgji Eftremov, pasi ai kishte kërkuar ndarjen e Maqedonisë dhe shpërnguljen të popullatave. Këtë, “marrëzi” Eftremov, u tha se e “gatoi” gjatë dreke, kur ai ishte kryetari i akademisë maqedonase aso kohe, dhe ia kishte paraqitur këtë ide shtërpe, edhe një homologut të tij shqiptar, si “një propozim, gjoja për zgjidhjen e krizës së at’hershme, nëpërmjet shkëmbimit të territoreve dhe të popullsisë midis dy shteteve, Maqedonisë dhe Shqipërisë.”

Fantazira të këtilla (ose çmendurira), në rradhë të parë nuk i shërbejnë aspak paqes, sigurisë dhe stabilitetit të Ballkanit, e rajonit, në përgjithësi. Ato janë vlerësimet më primitive me ndjenjë të sëmurë shoviniste, të një populli tjetër, që të na kujtojnë kohë të kaluara, e të errëta, si ato gjatë kohës së ish - republikave Jugosllave”. Në deklaratën dhe shtrembërimet e qellimit e dashakeqëse, të akademikve maqedonas në Enciklopedinë, për hesap të tyre, në paraqitjen e historisë së këtij shteti, i cili kujtojmë se është shtet i vetem në botë, që megjithëse ka më shumë se 18 vjet, që komuniteti ndërkombëtar ishte ai që e bëri shtet, është shtet ky, që, nuk ka ende indetitet kombëtar, nuk ka ende një flamur zyrtar, të njohur nga e gjithë bota, dhe nuk ka ende një emër zyrtar, që të përdorej nga e gjithë bota. Por, dikush e quan, FYROM, dikush e quan, Maqedoni, Maqedonia Veriore, Republika e Maqedonisë Veriore, dhe mos më keq dikush tjetër, e ka lënë edhe pa emër, fare....

Akademisë së Shkencave Shqiptaro-Amerikane, me qendër në New-York, thuhet se ky skandal i pashembullt për nivelet akademike, shtyn të mendohet me tërë seriozitetin për pozitën e shqiptarëve në Maqedoni. Të cilët, megjithëse janë pjesë e rëndësishme shtetë-formuese të këtij shteti, ende trajtohen e shifën nga akademikët maqedonas dhe krerët e këtij shteti, si qytetar të dorës së dytë dhe të tretë.

Ndaj, pa hezitim dhe duke përdorur të gjitha format zyrtare, deri tek protestat para ambasadës maqedonase në Uashington, dhe Misionit të saj diplomatik në OKB, Akademia e Shkencave Shqiptaro-Amerikane, me qendër në New-York ka vendosur t'i drejtohem mi me këtë rastë, si qytetar amerikan, në bazë të Amandamentit të Parë të Kushtetutës Amerikane, Departamentit Amerikan të Shtetit, Arkivit të Sigurisë Kombëtare, SHBA, dhe raportit të CIA-s për Maqedoninë, me një peticion, ku do të kërkohet që menjëherë të ndalohet botimi dhe publikimi i kësaj Enciklopedie, dhe heqja e menjëherëshme saj nga qarkullimi, dhe që akademikët maqedonas që hartuan këtë çorbë, tju kërkohet ndjesë shqiptarëve.

intervistë

Ndërtimi, dhe veçanërisht vënia në shfrytëzim e kësaj rruge do të ketë një impakt të jashtëzakonshëm, jo vetëm për Dibrën, por edhe për trevat e banuara nga shqiptarët në Maqedoni, për zonën e Matit, Tiranën, Durrësin e të gjithë vendin.

Flet Dr. Ing. Faruk Kaba

“Ja detajet e projektit nga Bulqiza në Tiranë”



Pyetje: Rruga e Arbërit në aspektin e projektimit mund të konsiderohet e përfunduar. Projekti i lotit më të vështirë të kësaj rruge që nis nga Ura e Vashës në Klos deri në dalje të tunelit në malësinë e Tiranës është disenjua plotësisht dhe ka kaluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve. Me konkretisht ç'mund të thoni për këtë projekt?

- Ashtu është. Projekt-idea është dorëzuar në DP të Rrugëve dhe pritet të shqyrtohet shumë shpejt nga ky organizëm. Ka qenë një projekt shumë i vështirë për zgjidhje, pasi pothuaj mungonin alternativat, ndërsa luginat kanë një zhvillim, që nuk përputhej me ato ç'ka kërkohen nga rrugë të këtyre standardeve. Megjithatë, zgjidhjet përfundimtare janë gjetur dhe tani pritet të miratohen, për t'u materializuar në projekt zbatimin e rrugës dhe menjëherë me procesin e ndërtimit të saj.

Sidoqoftë, ka qenë e nevojshme që të kapërcehet Qafa e Murrizës me një tunel rreth 3.5 kilometra të gjatë dhe më pas një tunel në afërsi të Gurit të Bardhë me gjatësi rreth 0.6 kilometra. Por nuk ka qenë vetëm kjo vështirësi. Në një pjesë të konsiderueshme pranë Urës së Vashës, terreni në luginën e lumit Mat është tejet i aksidentuar, i thyer. Kjo na ka detyruar të kalojmë me gërmime të mëdha, me mure dhe ndoshta kur të merren të gjitha detajet e terrenit, pasi të përcaktohet varianti përfundimtar, edhe me ndonjë tunel tjetër.

Vështirësia tjetër më e madhe ka qenë kapërcimi i Luginës së Matit me urë, pranë Urës së vjetër të Vashës. Edhe për këtë janë bërë me dhjetëra tentativa dhe së fundi është përgatitur ajo që e mendojmë si zgjidhja më e mirë: një urë e një tipi të veçantë, e pandërtuar ndonjëherë në vendin tonë, me gjatësi rreth 300 metra, me tre hapësira, ku hapësira më e madhe është 140 metra. Ky tip, që në teknikën botërore quhet “me konsola” apo “kantilever”, do të përdoret për herë të parë. E veçantë është se lartësia e urës është rreth 133 metra, pra më shumë se tre herë lartësia e hotelit në qendër të Tiranës ose rreth 50 metra më e lartë se ura më e lartë në aksin Rrëshen-Kalimash.

Rruga do të ketë edhe një serë veprash të tjera, ndër të cilat spikasit tre viadukte me lartësi mbi 20-25 metra secili, dhjetëra ura të tjera të shumta më të vogla, mure në formën e “terra armata”, një teknologji e veçantë kjo për urat e këtyre madhësive e të tjerë vepra



Pamje nga Rruga e Arbërit, Fushë - Bulqizë.

Foto: Bujar Karoshi

më të vogla. Do të lëvizin rreth 2 milionë e 300 mijë metra kub dhera, pjesa më e madhe shkëmbore. Rruga do të jetë e asfaltuar me gjerësi 9 metra të asfaltit dhe dy bankina të paasfaltuara nga 1 metra, pra gjithsej 11.0 metra. Parametrat gjeometrike janë të tillë që do të lejojnë një lëvizje me shpejtësi 80 deri 100 kilometra në orë pa probleme, pasi e gjithë rruga do të shoqërohet me një sinjalistikë moderne bashkëkohore. Rruga do të shoqërohet me sinjalistikë dhe masa inxhinjerieke për një siguri të lartë dhe komode në lëvizje.

Rruga do të ketë dhe një lidhje të veçantë me rrugën nacionale Burrel-Klos - Bulqizë, e cila nga Klosi tek Ura e re e Vashës do të jete 3 kilometra e gjatë. Në këtë mënyrë edhe Burreli do të lidhet me Tiranën në një distancë prej vetëm 57 kilometra, ndërsa Klosi me vetëm 40 kilometra.

Pjesë e Rrugës së Arbërit është një tunel rreth 3.3 kilometra, që siç keni deklaruar në “Alsat TV” është në përfundim në fazën e projekt-idesë dhe pritet vetëm hartimi në detaj për inspektimet si dhe miratimi dhe këshillat teknike. A mund të jepni detaje të kësaj projektideje?

- Siç e përmenda dhe më lart projekti përfshin dhe një tunel me gjatësi 3.3 kilometra, që mund të jetë dhe alternativa fituese, pasi janë paraqitur edhe dy variante të tjerë me tunele me gjatësi 3.6 dhe 4.2 kilometra. Tuneli është me të vërtetë një vepër shumë e vështirë. Ai krijon mundësinë e kapërcimit të Qafës së Murrizit me kuote rreth 1320 metra, që ndan malësinë e Tiranës me atë të Matit. Tuneli është projektuar të kalojë në kuotë 800-820 metra, që bën të mundur kushte më të favorshme nga pikëpamja e dëborës dhe

faktorëve të tjerë atmosferikë. Ulja në kuota më të ulta ka qenë pothuaj e pamundur pasi do të duhej të zgjatej në mënyrë të jashtëzakonshme ky tunel, dhe sigurisht është kostoja e tij dhe vështirësia.

Megjithatë, mund të themi se kjo pjesë rruge dhe në përgjithësi rruga e Arbërit, kanë një kosto tejet të lartë, rezultat ky i terrenit ku kalon. Vetëm tuneli i Murrizit, kushton rreth 90 milionë euro. Vështirësia e tij shtohet po të kemi parasysh kushtet gjeologjike ku kalon ky tunel, të cilat janë nga më të dobëtat. Për të përcaktuar pozicionin më të përshtatshëm të tij janë bërë tentativa të shumta dhe grupi i inxhinierëve është i besimit se ka gjetur pozicionin më të përshtatshëm.

Tuneli fillon në shtëpitë e sipërme të fshatit Murrizë nga krahu i Tiranës dhe del në grykën e lumit të Mashnorit, pranë shtëpive të fshatit Xibër, poshtë shkollës së këtij fshati, në kuota rreth 820 metra mbi nivelin e detit. Afati i ndërtimit të tij, në një farë mënyre do të kondicionojë edhe afatin e ndërtimit të të gjithë rrugës, por përderisa Kryeministri Berisha ka deklaruar një afat rreth 2 vjeçar, mendoj se kjo do të realizohet plotësisht.

Ç'mund të thoni për ecurinë e deritanishme dhe cilat do të jenë avantazhet e ndërtimit të kësaj rruge?

- Deri tani kanë përfunduar ose janë në përfundim 4 nga 5 Lote të rrugës së Arbërit. Loti i 5 është një lot i shkurtër rreth 5 kilometra, jo i vështirë, por që kërkon dhe marrjen e miratimit nga pala maqedonase për pikën e kalimit të kufirit. Pra, mund të themi se projekti është çështje e mbyllur. Ndërkohe, pothuaj ka përfunduar një lot (nga Bulqiza në Urën e Cerencit) dhe ka filluar puna në lotin paraardhës nga Bulqiza në

Klos (Ura Vashës). Menjëherë me dorëzimin e projekt-zbatimit të dy loteve të tjerë Tiranë (Ura Brarit) - Tunel Qaf Murrizë dhe Tunel Qaf Murrizë - Ura Vashës (Klos) do të fillojnë punimet. Madje, ne si projektues po na kërkohet ky projekt sa më parë të jetë e mundur, për të filluar ndërtimin e saj.

Ndërtimi, dhe veçanërisht vënia në shfrytëzim e kësaj rruge do të ketë një impakt të jashtëzakonshëm, jo vetëm për Dibrën, por edhe për trevat e banuara nga shqiptarët në Maqedoni, për zonën e Matit pa përjashtim (pavarësisht skepticizmit të disa personave), por pse jo edhe për Tiranën, Durrësin e të gjithë vendin. Pasuritë e jashtëzakonshme të trevave të Dibrës andej dhe këtej kufirit do të vihen në lëvizje si kurrë më parë. Madje edhe një kuriozitet: Sofja, kryeqendra e Bullgarisë, me rrugën e Arbërit bëhet me afër me Durrësin, pra me detin Adriatik se sa me Detin e Zi. Në kushtet e një Europe të bashkuar dhe pa kufij, kjo është shumë domethënëse.

Por, nga të gjithë trevat ato që janë më pranë rrugës do të kenë edhe përfitimet më të mëdha. Dhe kjo është e natyrshme. Kjo është edhe arsyeja përse dibranët mezi e presin këtë vepër të rëndësishme rrugore, të mirat e cilës do t'i shijojnë të gjithë shqiptarët.

Rruga e Arbërit duke patur këto cilësi është edhe një alternativë shumë tërheqëse e Korridorit të 8-të Paneuropean dhe si e tillë do të jetë tërheqëse për një transport shumë më të gjerë se ai që përmendëm deri këtu. Personalisht uroj që të përfundojë sa më parë të jetë e mundur, për të mbyllur një epokë të vështirë transporti dhe për të hapur një epokë të re. “Via vita est” thonin romakët dhe për Dibrën kjo shprehje është mëse domethënëse dhe kuptimplotë.

■ Pasuritë e jashtëzakonshme të trevave të Dibrës andej dhe këtej kufirit do të vihen në lëvizje si kurrë më parë.

■ Sofja, kryeqendra e Bullgarisë, me rrugën e Arbërit bëhet me afër me Durrësin, pra me detin Adriatik se sa me Detin e Zi. Në kushtet e një Europe të bashkuar dhe pa kufij, kjo është shumë domethënëse.

■ Qafa e Murrizës do kalohet me një tunel rreth 3.5 kilometra të gjatë dhe më pas një tunel në afërsi të Gurit të Bardhë me gjatësi rreth 0.6 kilometra.

■ Një urë e një tipi të veçantë, e pandërtuar ndonjëherë në vendin tonë, me gjatësi rreth 300 metra, me tre hapësira, ku hapësira më e madhe është 140 metra do të ndërtohet mbi urën e Vashës.

■ Rruga do të ketë edhe një serë veprash të tjera, ndër të cilat spikasit tre viadukte me lartësi mbi 20-25 metra secili, dhjetëra ura të tjera të shumta më të vogla, mure në formën e “terra armata”, një teknologji e veçantë kjo për urat e këtyre madhësive e të tjerë vepra më të vogla.

■ Rruga do të jetë e asfaltuar me gjerësi 9 metra të asfaltit dhe dy bankina të paasfaltuara nga 1 metra, pra gjithsej 11 metra.

■ Parametrat gjeometrike janë të tillë që do të lejojnë një lëvizje me shpejtësi 80 deri 100 kilometra në orë pa probleme, pasi e gjithë rruga do të shoqërohet me një sinjalistikë moderne bashkëkohore.

■ Rruga do të ketë dhe një lidhje të veçantë me rrugën nacionale Burrel - Klos - Bulqizë, e cila nga Klosi tek Ura e re e Vashës do të jete 3 kilometra e gjatë. Në këtë mënyrë edhe Burreli do të lidhet me Tiranën në një distancë prej vetëm 57 kilometra, ndërsa Klosi me vetëm 40 kilometra.

■ Tuneli fillon në shtëpitë e sipërme të fshatit Murrizë nga krahu i Tiranës dhe del në grykën e lumit të Mashnorit, pranë shtëpive të fshatit Xibër, poshtë shkollës së këtij fshati, në kuota rreth 820 metra mbi nivelin e detit.

Kostoja që i shkaktajnë shtetit ato që shpërngulen drejt zonave urbane duhet t'u kthehet në formën e investimeve atyre që banojnë në këto zona

Nga DALI HORESHKA

Gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009 bujqësia shqiptare njohu një hap progresiv, duke kaluar nga mbështetja financiare indirekte tek ajo direkte ndaj fermerit. Vetëm rajoni i Dibrës ka patur mbi 400 përfitues, të cilët kanë investuar mesatarisht me fonde shtetërore në formën e subvencionit 250.000 lekë secili, kryesisht në ngritjen e pemëtoreve të reja.

Skemat e zbatuara gjatë viteve 2007-2009, pa hyrë në analiza të hollësishme, dëshmuar se:

- u formua një përvojë pozitive në mënyrën e hartimit të skemave dhe udhëzimeve për zbatimin e tyre;
- zbatimi dhe ndjekja e skemave kërkojnë një ekip të posaçëm njerëzish, siç është ai i Drejtorive të Bujqësisë, për të cilat mendoj se opinioni i përgjithshëm është se kanë qenë të suksesshëm;

- u thellua më tej zhvillimi i parabarabartë midis rajoneve të vendit, nëpërmjet kriterëve të njëjta të konkurrencës për të përfituar nga subvencionet. Kjo pamundësi e disa rajoneve për të përfituar ngjan me pamundësinë e një fermeri për të patur akses me një operator telefonik, kur kartat telefonike janë me prerje vetëm 1000 lekëshe dhe fermeri në fakt ka vetëm 200 lekë. Këtë mundësi e ka vetëm një përqindje e vogël e popullsisë, e cila në rastin e bujqësisë ka sipërfaqe të madhe dhe në rastin e telefonisë ka paratë. Logjikisht i bie që **zona verilindore gjithmonë mbetet më e disfavorshme.**

Arsyet për të cilat vendosja të shkruaj, duke mos u fokusuar shumë tek ana kritike se sa tek ajo se çfarë e si duhet përmirësuar skema, janë tre:

Kriza globale

Analizat e përfitimeve nga një produkt apo sektor i caktuar, shpesh bëhen thjesht si diferencë midis çmimit dhe koston dhe vetëm për produktet që dalin në treg. Unë do të sugjeroja që **mbështetja duhet të ekzistojë edhe për sigurinë ushqimore, duke e konsideruar atë si burim direkt të punësimit të brendshëm.** Në këtë mënyrë zvogëlohet mundësia e prekjës nga faktorët e jashtëm, siç është kriza ekonomike që po kalojmë, e cila është quajtur "recesion" apo "stanjacion ekonomik". Bujqësia përbën faktorin kryesor që Shqipëria nuk u prek sa vendet e tjera nga kriza globale.

Varfëria

Me një mbështetje më serioze dhe domethënëse nga pikëpamja e fondëve dhe e integruar me gjithë burimet e mundshme të sigurimit të fondëve e sidomos me nxitjen e kapitalit dhe njohurive të emigranteve në përmirësimet teknologjike, rezultatet do të ishin doemos të prekshme.

Lehtësimi i zonave urbane nga popullimi i mëtejshëm dhe joshja e rikthimit në këto zona

Jo vetëm unë kam bindjen se përmirësimi i infrastrukturës rrugore do të japë efektet pozitive të ringritjes ekonomike. Por, fillimi i një



Subvencionet bujqësore, investime të suksesshme

rikonceptimi të zhvillimit rural, duke e parë sa më afër me atë urban dhe duke dhënë mbështetjen dhe vëmendjen e nevojshme, do të sillte reagimet e mosshpërnguljeve dhe të rikthimit të atyre që janë zhvendosur më parë, parë kjo në mënyrë relative. **Kostoja që i shkaktajnë shtetit ato që shpërngulen drejt zonave urbane duhet tu kthehet në formën e investimeve atyre që banojnë në këto zona apo që rikthehen.**

Të tre arsyet e mësipërme janë të mjaftueshme për të thënë se hapi i bërë gjatë tre vjetëve ishte pozitiv dhe duhet shtrirë më tej dhe në mënyrë të matur. Duke menduar se nuk përfaqësoj vetëm opinionin tim, më poshtë do të rendis disa nga përmirësimet që mund ti bëhen skemës së subvencionit të vitit 2010. Në tërësi, dhënia e mendimeve është udhëhequr nga parimi i të parit të subvencionit si mjet zhvillimi të qëndrueshëm dhe jo si evidencë e shpërndarjes së parave. Disa nga sugjerimet janë renditur më poshtë.

Kërkesat e tregut për produkte bujqësore

Ka ardhur koha që rekomandimet për të mbjellë ose përpunuar iks produkt (le të themi mollë starking) të jepen duke studiuar më parë kërkesën e tregut për to. Këto vrojtime duhen bërë në tre nivele: ndërkombëtar, kombëtar dhe rajonal. Fakti që Dibra, p.sh. nuk ka më shumë se 1000 ha pemëtari dhe se sipërfaqja totale bujqësore e pyjore është rreth 75000 ha, shpreh më së

■ Ka ardhur koha që rekomandimet për të mbjellë ose përpunuar iks produkt (le të themi mollë starking) të jepen duke studiuar më parë kërkesën e tregut për to. Këto vrojtime duhen bërë në tre nivele: ndërkombëtar, kombëtar dhe rajonal. Fakti që Dibra, p.sh. nuk ka më shumë se 1000 ha pemëtari dhe se sipërfaqja totale bujqësore e pyjore është rreth 75000 ha, shpreh më së miri faktin që një pjesë domethënëse e rajoneve/fshatrave nuk kultivojnë pemëtari dhe kanë nevojë për këto produkte. Orientimi i shërbimit këshillimor bujqësor dhe mekanizmave të tjerë të bujqësisë drejt tregut dhe marketingut përbën një emergjence.

miri faktin që një pjesë domethënëse e rajoneve/fshatrave nuk kultivojnë pemëtari dhe kanë nevojë për këto produkte. **Orientimi i shërbimit këshillimor bujqësor dhe mekanizmave të tjerë të bujqësisë drejt tregut dhe marketingut përbën një emergjence.**

Raporti i investimeve publike ndaj atyre direkte ndaj fermerit nëpërmjet subvencionit bujqësor. **Raporti midis tyre do të ishte në masën që investimet publike pengojnë iniciativën zhvilluese apo i japin një hov të mëtejshëm dhe e bëjnë më të efektshëm.** Kjo do të kërkonte kthimin e sektorëve të statistikës sidomos në rajone, në sektorë që "shtrydhin" treguesit në funksion të "prodhimit" të gjetjeve dhe rekomandimeve optimale.

Për tre vite rresht përcaktimi i numrit të skemave është bërë nga Ministria e Bujqësisë. Tani ka një mendim se ky përcaktim mund të jetë kompetencë e Drejtorive Rajonale të Bujqësisë. **Ky decentralizim i nevojshëm shumë lehtë mund të kthehet në një të keqe edhe më të madhe nëse këto të fundit nuk orientohen në mënyrën se si mund të përcaktohen drejtimet apo skemat më të favorshme për tu subvencionuar.**

Pikësëpari kjo do të kërkonte një klasifikim rajonal të zonave për tu mbështetur, duke i patur të ndara në tre nivele: fushore malore, kodrinore malore dhe malore.

Qysh në fillim të shkrimit kemi vënë në dukje se skemat e deritanishme kanë thelluar zhvillimin e parabarabartë midis rajoneve. **Ky efekt**

negativ duhet korriguar duke marrë në konsideratë nevojat e rajoneve, duke patur parasysh shkallën e zhvillimit të tyre dhe atë të prapambetjes.

Cilat skema duhen mbështetur?

Problemi duhet parë në dy aspekte: cilin produkt dhe në cilën fazë. Me fjalë të tjera: cilat produkte kërkon tregu dhe "ku i dhemb" produktit. Me të drejtë ka propozime që mbështetja e qendrave frigoriferike për mollën, futja në skema e arrorëve dhe e kultivimit të bimëve mjekësore duhet të jetë me përparësi. Këtu gjej vendin të shpreh se Ministria e Mjedisit duhet të "kopjoje" modelin e mbështetjes që ka përdorur Ministria e Bujqësisë për të nxitur shfrytëzimin efektiv e të balancuar të produkteve të dyta pyjore, pse jo dhe të turizmit malor pyjor.

Si për çdo gjë të re që nisim kemi vështirësi e ndjejmë nevojën të mbështetimi duke na treguar teknologjinë, tregun e prodhimit, atë të inputeve etj, edhe për qendrat frigoriferike e industrinë, arrorët dhe bimët mjekësore kemi nevoja të tilla. Në qoftë për frutat apo blegtorinë përvoja ka ekzistuar dhe evoluar për shkak të kontributit të Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore dhe përvojës së sjellë nga emigracioni, për të tjerat kjo përvojë duhet ringritur apo rigjetur.

Subvencionim apo mbulim interesash bankare

Skemat që mendohet se duhen mbështetur duhen analizuar nga pikëpamja e periudhës brenda së cilës ato sjellin të ardhurat. Ato skema, produkte apo shërbime të cilat sjellin të ardhura brenda vitit dhe në mënyrë efektive, duhen kredituar duke u mbuluar interesat bankare. Produktet që sjellin të ardhura dhe në mënyrë efektive pas gjashtë muajsh apo një viti duhen subvencionuar. Periudha e kreditimit dhe afati i kthimit sigurisht është në varësi të bankave, por kur ato kanë një garantsi, unë besoj se është në interesin

Në foto: Ferma me mollë e rrush e z. Hysen Mani nga fshati Pekë, Dibër, i cili nuk ka kërkuar asnjëherë të përfitojë nga fondet shtetërore. Kodra përballë ka nevojë për to... Foto: B. Karoshi

■ **Nga llogaritjet mbi koston e qendrave frigoriferike rezulton se kostoja e investimit është maksimalisht 30 lekë/kg në vit, shpenzimet operative janë maksimalisht 10 lekë për kg/vit dhe e ardhura neto është minimalisht 20 lekë/kg. Kjo do të thotë se për një periudhë maksimalisht prej dy vjetësh ato e shlyejnë investimin e bërë.**

e tyre të negociojnë. **Programet e zhvillimit duhet të bëhen garantuese të këtyre interesave.**

Koordinim e orientim i programeve dhe drejtësi në mbështetje

Nga llogaritjet mbi koston e qendrave frigoriferike rezulton se kostoja e investimit është maksimalisht 30 lekë/kg në vit, shpenzimet operative janë maksimalisht 10 lekë për kg/vit dhe e ardhura neto është minimalisht 20 lekë/kg. Kjo do të thotë se për një periudhë maksimalisht prej dy vjetësh ato e shlyejnë investimin e bërë. Nisur nga ky arsytim, i them një ditë një mikut tim: "Përse nuk po ndërton një qendër frigoriferike kur ti për dy vjet arrin të prodhosh 50 ton mollë në vit", duke marrë një kredi ndoshta pa interes?" Ai mu përgjigj duke më thënë se përderisa kam ku të marr grande përse duhet të marr kredi? Të tjerët, më shpjegoi ai, kanë përfituar grande dhe përse unë nuk duhet të përfitoj. Unë ju përgjigja se "të presësh për atë që është e nevojshme dhe me leverdi do të thotë të humbësh". Ti humbet, i thashë mikut tim, me 50 ton prodhim, jo me pak se 1 milion lekë neto në një vit. Mesazhi që dua të përcjell është i qartë: **unifikimi i politikave mbështetëse dhe koordinimi i tyre.** Një tjetër koordinim, i cili mendoj se ka munguar është ai midis programit mbështetës të zhvillimit bujqësor dhe të atij rural.

Duke menduar se krijimi i dialogjeve për të fokusuar më të mirën ndihmon politikëbërësit dhe zbatuesit, do të doja të bëja thirrje ndaj medias për të patur më në fokus debate mbi zhvillimin bujqësor dhe atë rural. Duke mos pretenduar se problemet dhe propozimet e ngritura janë më perfekte, do të ftoja gjithë dashamirësit e bujqësisë dhe zhvillimit rural të ngrënë më shumë problematika në lidhje me këtë temë si nëpërmjet gazeteve ashtu edhe nëpërmjet emisioneve televizive.

Titulli është i redaksisë. Titulli i origjinalit është "Subvencionet bujqësore të ndryshimit dhe ndryshimi i subvencioneve"

Shumë shpejt, kjo zonë mjaft e bukur dhe e pa eksploruar ende nga turizmi, do të kthehet në një nga zonat më të njohura në vendin tonë.

Luginës së Tujanit

Nga: **SHAQIR SKARRA**

Autobuzi ndalon në stacionin e fundit e njerëzit që shkelin për herë të parë rreken të kërkojnë "Kafen e Rremës". Sot këtu ka mjaft kafe por kafe me të njëjtin emër nuk ekziston më. Kjo ka mbetur thjesht si toponim. Vetëm pak metra aty ku ndalon autobuzi përpara të shfaqet ish Ofiçina e artilerisë. Ndërtesa të shumta në prag të shkatërrimit, një tabelë tek porta kryesore që tregon se këtu është reparat ushtarak dhe kur futesh brenda nuk ka asgjë që të quhet reparat ushtarak. Ajo ofiçina e zhurmëshme e riparimit të armatimit të artilerisë sot duket si e shkretë. Pikërisht këtu fillon dhe rruga e Arbërit e cila do të bashkohet me segmentet e tjerë që kanë nisur. Në fakt rruga e Arbërit apo e Dibërës siç quhet në popull nis në sheshin kryesor të metropolit, aty ku kryqëzohen katër rrugë: Rruga e Elbasanit, e Kavajës, e Durrësit dhe tashmë më e reja e Arbërit. Rruga vazhdon përgjatë rrugës së Dibërës, kalon në rrugën "Myslim Keta" e fillon traseja e re tek Ofiçina e Artilerisë. Kjo është një nga rrugët më të vjetra por në fakt sot është më e reja që po ndërtohet. Rruga e Detit apo rruga e Arbërit e ka origjinën nga Periudha Romake, shekulli I dhe II, siç dëshmojnë stacionet rrugore (Mansasaj) të Gurit të Bardhë. Në shekullin e XI, rruga përmendet nga kronistja britanike, Ana Komnena, ndërsa në vitin 1257 këtej kaloi komandanti britanik Gjergj Akropoli. Normanët e Boemundit kalonin në këtë rrugë gjatë luftimeve. Në deqterin turk të vitit 1467 Guri i Bardhë përmendet si fshatrat "Dervene" që ruajnë e mirëmbanin rrugën. Kjo rrugë sot me kushte më të mira gjeologjike-inxhinierike e hidrologjike do të vlejë fare mirë si alternativë e Koridorit të 8-të. Ngaqë rruga nga qendra e Tiranës deri tek Ofiçina e Artilerisë është e përfunduar, pritet të nisim punimet për rrugën e Arbërit pikërisht këtu. Projekti teknik për këtë segment është dorëzuar dhe vetëm pritet tenderimi që të nis gjëmimi i minave luginës së Tujanit. Shumë shpejt kjo zonë mjaft e bukur dhe e pa eksploruar ende nga turizmi, do të kthehet në një nga zonat më të njohura në vendin tonë. E padyshim që rruga e Arbërit është ajo që do ta bëjë të njohur brenda dhe jashtë vendit këtë luginë të rrallë që natyra ia ka falur kësaj zone. Jo vetëm kaq, por e gjithë distance e rrugës së Arbërit është turistike. Mjafton të përmendim vetëm kalanë e Grazhdanit, një më vjetër dhe më të mëdhatë në vendin tonë por që ende nuk njihet nga të huajt. Me përfundimin e rrugës së Arbërit kjo do të vizitohet ndoshta dhe më shumë se vetë Butrinti.

Gjurmës së rrugës së vjetër

Në fakt lugina e Tujanit nis pikërisht tek ura e Brarit, urë kjo e ndërtuar në kohën romake e sot është po thuhet në shembje pasi nuk ka vënë njeri dorë në mirëmbajtje. Këtu e kishim lënë të takoheshim herët në mëngjez me inxhinierin Bashkim Lleshi ku do të shkelnim të gjithë trasenë e rrugës së Arbërit deri në hyrje të tunelit të Murrizës. Bashkimi si njeri tepër korrekt kishte kohë që priste. Udhëtimi ynë nëpër Luginën e Tujanit ishte planifikuar herët por kjo u bë më shumë edhe nga dëshira e biznesmenit dibranë me aktivitet në Tiranë zotin Fatmir Kurti. Ndaj Fatmiri bashkë me makinën e tij nuk na la të prisnim gjatë. Bashkë me të ishte dhe Artur Kalia, punonjës pranë komunës Selishtë e Halil Alla, një tiranas i vjetër nga fshati Selitë. -Halili është një njohës i mirë i kësaj zone, ndaj sot do të bëjë dhe punën e ciceronit, nisi bisedën Fatmiri pas përshëndetjes që bëmë. Halili ishte nga kjo zonë, ishte lindur dhe rritur këtu dhe domosdo e njëjtte mirë terrenin por më mirë njëjtte edhe gjurmën e vjetër të rrugës këmbësore nga ku kishin shkelur dibranët në vitet e hershme. Jo vetëm kaq por dinte edhe toponimet e haneve ku kishin bujtur udhëtarët e kësaj rruge të vjetër. Inxhinier Bashkimi ishte ndër nismëtarët e parë të këtij projekti gjigand por dhe një ndër

inxhinierët që kishte marrë pjesë në studimin e fizibilitetit të rrugës dhe nuk ishte hera e parë që shkelte kësaj ane. Makina u shkëput dhe kështu u nisëm në rrugën ekzistuese të Zalldajtit, rrugë kjo që ecte përgjatë luginës së Tujanit. I pari që e thyen heshtjen tonë është inxhinier Bashkimi. -Ja matanë lumit do të hapet traseja e re. Vërtet matanë ku do të hapet traseja e rrugës është shkëmb i fortë por shumë shpejt do t'i bindet forcës së eksplozivit dhe fuqisë së eskavatorëve të mëdhenj. E gjithë traseja do të shtrihet përgjatë lumit të Tiranës dhe vende vende do të bashkohet me gjurmën e rrugës së vjetër nga skarpatat e larta që do të hapen. Para nesh shfaqet një shkëmb me një lartësi mbi 100 metra. -Ja këtu i thonë brinja e Caracit, tregon Halili, apo vendi i rrezikshëm. Është vendi më i vështirë për këmbësorët që kanë bërë këtë rrugë. Sipër nesh duket vërtet gjurma e rrugës së vjetër, rrugë i thëncin se as dhitë nuk mund të lëvizin lirshëm. Megjithatë nëpër këtë shkëmb kanë kaluar dibranët me karvane kur zbrisnin në Tiranë por dhe kur dilnin nga Tirana, tregon Halili. Sa e sa kuaj e mushka u kanë ikur dibranëve në këtë shkëmb e kanë rënë këtu në luginë. Ka patur raste që ky shkëmb ka marrë dhe jetë njerëzish, udhëtarë që shkelnin kësaj rruge, vazhdon bisedën Halili. Pak më tutje shikojmë dy alpinist që ngjiten brinjën e Caracit. Edhe pse pylli ishte i veshur ende që larg dukej gjurma e rrugës këmbësore e kjo gjurmë shkante përgjatë gjithë luginës së Tujanit. Në Zalldajt humbiste nga rrapet e mëdhenj por dukej prapë në afërsi të liqenit të Shpallit. Bashkimi bën një foto dhe largohemi më tutje duke i lënë edhe alpinistët të zbavitën me sportin e tyre pa e ditur as vetë se me to do të takohemi përsëri gjatë rrugës. Sapo përfundon lugina e ngushtë, e thellë dhe mjaft e bukur me kanionet mahnitës të Tujanit para nesh shtrihet tashmë një pamje krejt ndryshe, një tjetër luginë dhe më e bukur se e para. -Tani fillon Zalldajti, thotë Bashkimi. Rruga shkon më së shumti në trasenë ekzistuese vetëm pak devijime do të ketë. -Dikur ka qenë një nga zonat më të populluara, sot ja siç po e shikojmë është krejt e braktisur, flet Halili. Kjo ka qenë një qendër e madhe me shkollë të mesme e qendër shëndetsore. Vinin kuadrot nga Tirana e punonin në Zalldajt. Sot një realitet i zymtë, një trishtim dukej dhe në sytë e atyre banorëve të paktë që takuam.

-Ishalla bëhet kjo rrugë se kjo zonë përfiton shumë, na thanë disa gra tek po kalonin lumin më këmbë. Në qendër në përshëndetjen dy infer-



Lugina e Tujanit. Foto: Bashkim Lleshi

miere të cilat ngaqë qendra shëndetsore gjendej në pikë të hallit e ambulanca ishte e parkuar në një arë me jonxhë, po bënë një xhiro më këmbë përgjatë fshatit.

Tek ura që bashkohen tre lumenj

Bashkohen këtu tre lumenj: lumi i Shpallit, i Selitës dhe Shëngjinit. Të tre lumenjtë tek bashkohen bashkë përbëjnë atë që quhet lumi i Tiranës i cili përshkon me ujë të pastër si kristali luginën e bukur të Tujanit. -Të tre këto lumenj do të bashkohen brigjet e tyre me një urë-thotë inxhinier Bashkimi. Tashmë rruga del në shpatin matanë dhe me një ngritje të vogël që nuk mund të quhet malore ngjitet tek hyrja e tunelit të Murrizës i cili është i gjatë 3. 2 km. E gjithë kjo trase rruge nga Tirana deri në hyrje të tunelit është 28km, përfundon bisedën inxhinier Bashkimi. Kaluam më këmbë të tre lumenjtë pasi të tre ujë thua se nuk kishin fare dhe u ngjitem sipër për të parë më nga afër liqenin e Shpallit. -Një vend vërtet mahnitës, foli Fatmiri duke e parë me syrin e biznesmenit. Mavrova nuk është më mirë por infrastruktura ka bërë që të vizitohet shpesh nga turistët. Shpejt do ta shikojmë këtë zonë si një nga vendet më të kërkuara nga turistët e huaj, pse jo dhe nga shqiptarët. Ja ku jemi, poshtë malit të Dajtit, apo pas Dajtit. Vetëm mali e largon me metropolin shqiptar dhe infrastruktura, përfundoi bisedën Fatmiri.

Poshtë liqenit gjetëm një grumbull me gurë ku dukej qartë se dikur kishte qenë një ndërtesë e vogël ndoshta. -Këtu ka qenë një han ku qëndronin dibranët si kur ktheheshin nga Tirana, ashtu edhe kur vinin në Tiranë. Ja dhe gjurma e rrugës këmbësore sipër livadheve të Allajve. Hani i Llushe i kanë pas thënë. Dibranët shpesh kur hanet ishin plot trokisinin e dhe në fshatin tim në Selitë dhe asnjëherë nuk u është mbyllur porta miqve që vinin nëpër këtë udhë të gjatë e të vështirë. Megjithëse rruga ka patur shumë hane, ne nuk i mbyllim dyert e shtëpive natën pasi kjo rrugë kishte lëvizje në çdo orë. Dëshira ishte që të kalonim Qafën e Murrizës por ishte e pamundur të bëhej ajo rrugë tepër e thyer në këmbë pasi ishte dhe vonë. Inxhinier bashkimi na premtoi se do të vijmë përsëri kësaj ane që ta shikojmë më mirë ende pa filluar të shpohet me tunel Murrizja. -Do të dalim matanë në zonën e Klosit, tha Bashkimi, të ngjitemi në Xibër-Murrizës nga ku duket Guri i Bardhë dhe e gjithë lugina e Planit të Bardhë ku traseja e rrugës ka filluar deri tek Ura e Vashës. Segmenti i parë nga Ura e Çerenecit deri në Bulqizë ka përfunduar. -Do të vijmë, do të vijmë përsëri tha edhe Fatmiri dhe kështu morëm udhën e kthimit drejt Tiranës por dielli kishte humbur e nata po shtronte vellon e saj karakteristike në të gjithë luginën që do të shkelnim përsëri në rrugën e kthimit.

Një kafe në Zalldajt me Umberton nga Roma

Ndaluam në Zalldajt, në të vetmin në të vetmin lokal me pronar Shaban Mancaku. Një kafe ishte e domosdoshme pas një rruge të gjatë buzë lumit e mes rrapeve të lartë por për çudinë tonë këtu takuam alpinistët që ngjiten brinjën e Caracit. Umberto Di Paolo u prezantua italian se alpinisti tjetër ishte shqiptar vetëm se shoqëronte Umberton dhe falë emigrimit në Itali bënte dhe punën e përkthyesit. -Është viti i dhjetë që vij në Shqipëri, filloi të tregoi Umbertoja. Kam qenë në Sarandë, Shkodër, Durrës. Shqipërinë e njoh mirë. Pasioni im është alpinizmi dhe më shumë se çdo vend tjetër në vendin tuaj si Zalldajti dhe lugina e bukur e Tujanit për alpinizëm nuk ka gjëkund. E mora vesh se do të ndërtohet një rrugë e mirë kësaj luginë. Mirë bëhet kur ndërtohen rrugë por kam një merak të madh që gjatë ndërtimit të trasës të mos na e prishin këtë bukuri të kësaj luginë që nuk gjendet askund. Italianët nuk e njohin akoma Zalldajtin por jam i bëndur se po ta njohin sikur e gjithë kjo luginë të mbushej me hotele të vegjël prapë them se do të jetë pak. Atëherë keni për të parë se si do të vërshojnë turistët gjatë kësaj luginë. Mbrëmja na zuri në Zalldajt. U ndamë me Umberton dhe shoqëruesin e tij dhe u nisëm drejt Tiranës. -Do të kthehemi përsëri kësaj luginë-tha Fatmiri, por kur të fillojë puna. Ta shikojmë se si do të bjerë edhe brinja e frikshme e Caracit nga forca e eskavatorëve të mëdhenj, si do të shpohet tej e tej Murrizja e të bashkohet Tirana me Matin. Atëherë do të vijmë përsëri dhe shpresojmë se kjo ditë po afon.



Foto: Bashkim Lleshi



Umberto dhe Shaqiri Foto: Bashkim Lleshi

Në vitet e tranzicionit të tejzgjatur dhe të emigracionit të shfrenuar fshatra të tëra po zbrazen. Lëvizjet e tyre sa të detyruara, aq dhe të trishtueshme, e bëjnë të domosdoshme gjetjen e rrugëve, mundësive, mënyrave që këta njerëz sot, por dhe pasardhësit e tyre nesër, të mos harrojnë trojet stërgjyshore ...

Nga: MOISI MURRA

Më 2 gusht 2009 fisi Shehu i fshatit Zerqan ishte në festë. Pranvera, Fadil, Bujar Shehu kishin organizuar dhe përgatitur një takim, që siç u shprehën ata, kishte për qëllim "Të mos harrojmë vendlindjen". Kishin ardhur në këtë "Takim Brezash" anëtarë e miq të këtij fisi, që punojnë e jetojnë në Tiranë, Durrës e deri nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nisma e tyre duhet përshëndetur dhe inkuarjuar. Në vitet e tranzicionit të tejzgjatur dhe të emigracionit të shfrenuar, fshatra të tëra po zbrazen. Njerëzit lëvizin, ecin dhe kërkojnë një jetë më të mirë. Lëvizjet e tyre sa të detyruara aq dhe të trishtueshme e bëjnë të domosdoshme gjetjen e rrugëve, mundësive, mënyrave që këta njerëz sot, por dhe pasardhësit e tyre nesër, të mos harrojnë trojet stërgjyshore bëmat atdhetare dhe varret e të parëve të tyre. Fshati Zerqan është një nga fshatrat më të bukur të Dibrës. I vendosur në lartësinë 715m mbi nivelin e detit, në rrjedhjen e mesme të Zallit të Bulqizës, në të majtë të rrugës Peshkopi - Tiranë, me një sipërfaqe prej 2 km² duket si një fole shqiponje, që grish çdo njeri të gjejë kohë të kalojë disa çaste me të vërtetë mahnitëse, në mes gjelbërimit të pa anë dhe gurave të ftohta. Jo më kot të huajt e kanë quajtur Zerqanin "Vend i Artë". Gjetjet arkeologjike në Strikçan, Gotvi, Sofraçan dëshmojnë për një jetë qytetare ilire në këtë krahinë. Në dokumente e shkruar, Zerqanin e hasim për herë të parë, në një diplomë të Karlit të Parë Anzhu, që mban datën 18 maj 1278, që i dhuron fisnikun Pal Gropa disa fshatra në luginën e Bulqizës, ndër të cilin dhe Zerqanin, Zirkllanin në dokument. Në vitet e mëvonshme Zerqani ka shërbyer si qendër e pushtetit vendor (nënprefekturë, rreth, lokalitet, Këshill i Bashkuar dhe sot komunë e Rrethit të Bulqizës, që mbulon fshatrat: Gotvi, Krajë, Peladhi, Smallek, Sofraçan, Sopot, Strikçan, Ternovë e Vogël, Ternovë e Madhe, Valikardhë, Zall Sopot, Zall Strikçan dhe vet fshati Zerqan. Krahina e Zerqanit ose Grykës së Madhe ka dhe një ndarje etnokulturore, që rrok 11 fshatra: Valikardha, Zerqani, Sopot, Strikçani, Ternovë, Smollek, Lubaleshi, Krajka, Godvia, Peladhia, Sofraçani. Krahina e Zerqanit është e përmendur dhe për kostumet tradicionale popullore, që për larminë dhe forcën e ngjyrave, karakteristikat e veçanta kanë hyrë e qëndrojnë denjësisht në fondin e kulturës sonë kombëtare. Zerqanasit kanë bërë shumë për çështjen kombëtare. Mustafa Shehu (Sheh Mustafa në dialektin vendas), Sulejman Shehu, Riza Pashë Valikardha (Gurra), Riza Novaku, Dalip Gurra, Beqir Brata, Rahman Hanku, Medi Cani etj., që i panë dhe i matën ngjarjet e kohës me fuqinë e mendjes, humanizmin e rrallë, por dhe me grykat e armëve. Beteja e Drinit apo Lufta kundër Hajredin Pashës, korrik 1844, u organizua dhe u drejtua nga kleriku i njohur, atdhetari i shquar e dalazotësi i Dibrës e viseve të tjera shqiptare Mustafa Shehu. Gazeta "Albania" e Brukselit, 54 vjet nga koha kur u zhvillua Beteja kundër Hajredin Pashës, boton në korrik të 1898 këngën kushtuar kësaj beteje:

"...Nandë mijë vorre kush i bani
Gryka e Vogël e Sheh Zerqani"

Një fytyrë tjetër atdhetare, që rrezatoi urtësi, forcë, kulturë, arsim, drejtësi, organizim, humanizëm, dashuri, punë, gati për katër dhjetë vjeçarë, 1878-1917, në krahinë e Zerqanit dhe në mbarë Dibrën, është ajo e Sulejman Shehut (Sheh Sula) i Zerqanit. Ai mori pjesë në Lidhjen Shqiptare të

Takim brezash në Zerqan



Prizrenit, në Kongresin e Dytë të Manastirit dhe në të gjithë kuvendet parlament të Dibrës, që u mbajtën për organizimin e kryengritjeve kundër osmanëve e kundër serbëve. Sheh Sula i Zerqanit ka meritën e mësimi të alfabetit shqip të Stambollit, në Zerqan, që në vitin 1893. Stërmbesa e Sheh Sules, nga nëna (nga babaj është mbesë në Ukrainë), Alesia Cangoi, lexoi në "Takim brezash" prozën poetike të kujtimeve të nënë Xhemile Shehut, nxënëse e "Shkollës Shqipe" të Zerqanit të vitit 1893 kushtuar Sheh Sulës. Nën autoritetin e

tij absolut në maj të vitit 1910, u hap shkolla e parë shqipe. Për të gjitha këta si dhe për kapacitetin intelektual Qeveria e Ismail Qemalit e dekretoi Sheh Sulën nënprefekt të Krahinës së Zerqanit.

Në gjurmët e Mustafa e Sulejman Shehut ecën e bënë emër dhe shumë personalitete të këtij fisi. Përmendim këtu: Tush, Hajredin, Osman, Riza, Qamil, Myslim Shehu e të tjerë, të cilët u ulën në lëmin kombëtar dhe me një përkushtim e përgjegjësi qytetare shkruajtën faqe të lavdishme atdhetarie. Një rol shumë të rëndësishëm në

edukimin atdhetar, arsimor e shpirtëror ka luajtur Teqja e Zerqanit.

Ja pse nismëtarët e "Takim Brezash" menduan dhe organizuan festën e bukur të ditës së madhe, të 2 gushtit 2009, që është shumë domethënëse dhe që me të drejtë kanë përse të hedhin vështrim në të djeshmen, krenohen sot dhe shpresojnë për të nesërmen.

Më i moshuari i fisit, Fadil Shehu, nis të flasë, por lotët e tradhëtojnë para më të rinjve, nipërve e stërnipërve, mbesave e stërmbesave, kur sheh

Këshilli organizues mendon që "Takim Brezash" ta organizojmë çdo vit, të dielën e javës së parë të muajt gusht. Në takimet e ardhshme do të bëhen vizita në vende historike, në monumentet e kulturës, në monumentet e natyrës e në objektet e kultit, në të gjithë krahinën e Zerqanit.


gjithë ata të ardhur nga ana kand, që kanë ardhur për tu parë e për tu çmaltur me njëri tjetrin. Në këtë takim ishte i ftuar dhe imami i Xhamisë së Vjetër të qytetit të Peshkopisë, Sheh Suri. "Qënka një gja e mirë, - thotë Shehu, - do të propozoj, që ta organizojmë dhe ne një takim si ky i juaj". "Këshilli organizues, - thote znj. Pranvera Shehu, - mendon, që "Takim Brezash" ta organizojmë çdo vit, të dielën e javës së parë të muajt gusht". "Ne takimet e ardhshme, - shton Bujar Shehu, - do ta shtrijmë veprimtarinë duke bërë vizita në vende historike, në monumentet e kulturës, në monumentet e natyrës e në objektet e kultit, në të gjithë krahinë e Zerqanit. Do të trajtojmë dhe tema, që kanë të bëjnë me traditën, festa tradicionale, zakonet e ritet e dasmës. "Takim Brezash", siç e quajti një plak, po i vinte fundi. "Dasmorët" shtërngonin duart, përqafojnë e urojnë njëri - tjetrin: "Mirë u pafshmi pas një viti."

Luznia, Universiteti i Dibrës

Nga: MEVLUD BUCI

Nuk është fjala për të hiperpoli zuar apo hyjnizuar një trevë, sepse çdo trevë apo kullë e Dibrës e kudo në atdheun tonë ka një histori, ka një ngjarje a kronikë lavdie. Luznia ka të veçantën që buron nga shekujt e brezit; mprehtësinë e fjalës, lakonizmin e ligjërit intuitiv stigmatizuese e therëse nëpërmjet anekdotave dhe alegorive të cilat përmbajnë në to ironinë, sarkazmën, satirën dhe humorin. Kur ulesh e bisedon me luznakët të duket vetja vërtet se je para një dekanati, para një provimi të vështirë, sepse duhet të mendosh ku del manaja e fjalës, çfarë të thotë nënkuptimi i bendes, i rrotullës... Në disa studime tepër me vlera për Dibrën, a mençurinë popullore të kryera nga studiues të talentuar si Haziz Ndreu, Xhafer Martini, Shaqir Skarra, Hajri Mandri, Qeram Cibaku është cekur thjeshtë e e bukur edhe zgjuarsia e mprehtësia e të folurit alegorik të kësaj zone. Sa e thjeshtë e tërheqëse, aq edhe e thellë e satirike, sa domethënëse aq edhe figurative, sa kuptimplotë e e mprehtë aq edhe e bukur dhe edukative. E tillë është e folmja e Luznisë. Me të drejtë një i moshuar nga Lukani (atëherë 90 vjeç) u tha studiuesve Myfit Trepça, Qani Pertafti e Reshat Kola: "Luznakët flasin gjuhë zogjsh". Dikush iu përgjigj: - O xha Dali, luznakët janë kunjaxhi(!). - Jo, or bir, tha përsëri plaku. Ata kanë mendje të kulluar,

mprehtësi për të thumbuar. Ata kurrë nuk e tallin mikun por e provojnë, e lëmojnë, por nëse nuk ngacmohet e nuk u bie në va të fjalës atëherë debatojnë njeri me tjetrin me gjuhën e zogjve dhe vërshojnë pastaj me anekdotat ironizuese..." Pas çdo alegorie a dialogu në odat e Luznisë ka një mana, ka një ide e cila buron nga analiza apo diagnostikimi i faktit përballë që ka një të vërtetë kuptimplotë. Një gazetar nga Jugu erdhi mik në Katund të Ri të Luznisë. I tha të zotit të shtëpisë: "Meqë paska dasmë këtu afër a të shkojmë të shikojmë si i bëjnë dasmat luznakët? I zoti i shtëpisë, një burrë fisnik i priu para mikut dhe shkuan në dasmë. Mikun e vunë në krye të vendit dhe i bënë të gjitha nderet. Ngaqë jashtë binte dëborë, gazetari ishte mbuluar i gjithë me dëborë dhe sado që u shkund kur u fut në odë, kapelën e kishte e harruar pa u shkundur. Njëri nga dasmorët nisi bisedën: "Or Miftar, më kanë thënë se kishë blerë një tufë të mirë me dhen që do ta mbushin stallën e re, por u kishe vënë para një dash struke që nuk dinte me u shkundë(!)" Anekdotat dhe alegoria e Luznisë janë vërtet të rralla, me shprehje që përmbajnë plot nënkuptime, ngarkesë emocionale, satirë therëse, humor e mesazhe edukative. Kjo buron nga tradita e vyer e odave, nga intuita e të folurit me bende (mana) të pleqve. Janë të shumtë të urtët popullor luznakë që sot e kësaj dite përmenden nga breznitë si Elez Murrja, Bajram Nikolli, Maliq Nikolli, Idriz Palluçi, Ali Lika, Rremë Manuka, Demë



Seferi, Bajram Mera, Zenel Prethi, Sali Palluçi, Miftar Poliçi, Destan Manuka, Ibrahim Nikolli e plot të tjerë. E megjithatë luznakët nuk janë shquar vetëm për fjalën e mençur por kontributi dhe ndihmesa e tyre atdhetare është e lartë ku janë me dhjetra e dhjetra luznak që me gjakun e tyre kanë skalitur jo vetëm historinë e Luznisë por të gjithë Dibrës. E për këtë kanë shkruar vetë mjaft studiues luznak si Ibrahim Murrja, Aqif Doku, Ruzhdi Dedja, Lazim Prethi, Rustem e Mensur Murrja të cilët kanë argumentuar e argumentojnë me qartësi traditat e Luznisë. Është folur e shkruar për qëndresën e luznakëve me në krye trimin Isuf Murrja...

"Çaj Sufë Murrja një lanok,
ka zanë prajtën në atë Çenok,
N'atë Çenok e deri në Qep,

u shemb Luznia gra e pleq,
Namë po ban pushka e Luznisë
kundra mbretit të Turqisë..."

Po kështu luznakët treguan vendosmëri e qëndresë përkrah atdhetarit Lam Daci në Zogje:

"Kush asht çaj që lufton n'at kullë,
asht Lam Daci me do kullë,
nuk janë cullë por janë luznak,
pushkën fort e kanë zanat..."

Kronikë të veçantë përbën qëndresia kundër serbëve, ndihmesa në Lidhjen e Arrasit, ku Haziz Manuka i rrethuar me 70 vetë në kullën e tij vrau komandantin e serbëve dhe vetë çau në rrethimin në gusht të vitit 1920.

Vjen si testament në breza ajo çka i tha Elez Murrja valiut të Shkodrës, siç e shkruan studiuesi Ibrahim Murrja: "Dibra është Dibër, or Pashë e kur-

Emigranti nga Dibra, një ndër yjet e basketbollit amerikan

Nga: **BEQIR SINA, New York**

HOPATCONG LAKE, NJU XHERSIT: Mërgim Sina, aktualisht 42 vjeç, është biri i një emigranti të vjetër shqiptar nga Dibra (Peshkopia) - Muhurri. Familja e tij, e papajtuar asnjëherë me komunizmin dhe regjimin e Enver Hoxhës, u arratis më 1957, duke e sfiduar me risk sistemin diktatorial në Shqipëri. Mërgimi, emri i të cilit lidhet me emigrimin e kësaj familjeje, e njohur në rrethin e Dibrës, lindi më 1967 në Trieste - Itali, pikërisht gjatë kohës kur babai i tij Hashim Sina, dhe vëllezërit e tij Rasimi dhe Besimi, ishin refugjatë politik në Itali. Më pas ata emigruan në SHBA dhe Mërgimi, pati fatin e mirë të shkollohet në Amerikë. Një nga arritjet dhe sukseset më të mëdha të tij është basketbolli - kur ai për 6 vjet luajti për ligën e parë të basketbollit amerikan "NCAA Men's Division I Basketball Championship", prej vitit 1985 deri në vitin 1991. Më pas ai luajti në ligën profesionale të Basketbollit, në Europë (Itali, Spanjë, Belgjikë, Portugali), Azi (Japoni, Taivan, Filipine) dhe Amerikën e

rë nuk shtrohet"

Mençuria, trimëria dhe bujaria e luznakëve kanë rrezatuar e rrezatojnë në çdo kohë e brez. Me plot argument e krenari, me dhimbje e fakte shkruar në tetor të vitit 1993 Lazim Prethi i Luznisë nga Nju Jorku i Amerikës pasi argumenton historinë e qëndresës dhe karvanin e mundimeve ndër të tjera thotë:

"Sot jetoj me tre djem si tre pëlumba të vegjël. Uroj shqiptarët gjithmonë duke menduar e punuar për të kontribuar në ndërtimin e demokracisë shqiptare për begatinë e jetës së popullit martir të Shqipërisë. Uroj nga thellësia e zemrave tona, "Rroftë demokracia". Sot Luznia ka mjaft kuadro të cilët demonstrojnë urretësinë, traditat dhe shpirtin atdhetar. Në Luzni kanë lënë gjurmë edhe kuadro si Emri Sejfullaj, Shkëlqim Koltraka, Lik Berisha, Gafurr Zota, Hajdar Hajdari, Hajdar Poliçi e plot të tjerë. Në vitet e pasqllirimit në Luzni dha ndihmesën edhe mësuesi e studiuesi Qemal Haxhihasani, i cili ka lënë mjaft dorëshkrime për të folmen e veçantë të Luznisë. Sinonimi i humorit dhe ironisë së Luznisë është sot edhe aktori i madh e mjeshtri i humorit Behar Mera. Nga të folurit me mana e alegori cilido studiues bindet se Luznia është Universiteti i Dibrës. Luznakët janë e mbeten mjeshtra të fjalës, mendjemprehtë ku nëpërmjet të folurit lakonik, të figurshëm e me sens alegorik, demonstrojnë mençurinë e rrallë, satirën, mprehtësinë e fjalës. E me të drejtë pra Luznia e meriton plotësisht të quajten Universitet të Dibrës, një universitet ky i zgjuarsisë së lartë popullore, ku flet dituria, mjeshhtëria dhe bukuria e rrallë e fjalës.

■ Babai basketbollist profesionist në 4 kontinentet - i biri 15 vjeç - një ndër yjet e basketbollit amerikan

Jugut (Argjentinë e Brazil). Idhujt e tij, thotë Sina, janë: Magjikë Johnson, Larry Bird dhe Pete Maravich.

Revista më e madhe e sportit në Portugali "Planet-Basket", shkruan se Mërgim Sina është një emër që nuk ka si të kalojë pa u shënuar në historinë e njerzve të "mëdhenj" të basketbollit në Portugali. Të drejtën e tij për ta futur në historinë e basketbollit portugez, Sina e fitoi kur ai luajti si profesionist në Ligën Profesionale të Basketbollit Portugez, ku konkurroi në disa klube. "Planet" shkruan se ai ka hyrë në listën e të pavdekshmeve të basketbollit profesionist portugez si: Mikë Acad (93), Detit Side (94), Athletical (95) Ovarense (96) dhe të lliabum (98).

Mërgim Sina, i cili sot është një trajner i të rinjve në Amerikë, do të kujtohet gjatë për aq sa luajti basketboll profesionist, pasi ai ishte një basketbollist me karakter të rreptë. I lartë 1,99 metra do të rikthehej për të mbrojtur ngjyrat e kampionit të atyre viteve në Portugali. Deri më sot, Mërgimi vazhdon të mbetet i pathyer në rekordin e tij me 69 pikë të shënuara në një ndeshje në Portugali, më konkretisht në Kampionatin Kombëtar të Basketbollit, në vitin 1994.

Mërgim Sina, i cili për 20 vjet (1985-2005), preku majat më të larta të basketbollit profesional, në SHBA, Europë, Azi dhe Amerikën Latine, ka disa vjet (5 vjet) që merret me përgatitjen e talenteve të reja të basketbollit; femra dhe meshkuj në Amerikë. Ai i tha revistës sportive portugeze "Planet-Basket" se basketbolli, ende bënë pjesë në jetën e tij dhe nuk është vetëm një kujtim i tij. "Basketbollisti, - thotë Sina, - vazhdon të jetë pjesë e jetës sime. Ajo shtrihet tash 5 vjet tek puna ime në fushat e përgatitjes së të rinjve e të rejave e dedikuar programeve të basketbollit këtu në Nju Jersey, konkretisht në Akademinë e Basketbollit".

FENOMENI SINA, 15 VJEÇ "ENDËRRON" NBA

Jaren Sina, është djali i Mërgimit, i lindur në Hopatcong Lake, Nju Xhersit, më 1994 (15 vjeç) është i gjatë 5.6 feet (njësi matëse në Amerikë) e barabartë me 1.71 metra dhe luan për Divizionin e parë të të rinjve në SHBA - "15U Division Silver Champions".

Jaren (Jarin) Sina flet shumë pak shqip dhe dy fjalët më të dashura për të janë: "Jam shqiptar! Jam nga Dibra!". Jarini, siç i thërrasin këtu, luan aktualisht për skuadrën e basketbollit Hoop Heaven, në AAU.



Jaren (Jarin) Sina flet shumë pak shqip dhe dy fjalët më të dashura për të janë: "Jam shqiptar! Jam nga Dibra!". Jarini, siç i thërrasin këtu, luan aktualisht për skuadrën e basketbollit Hoop Heaven, në AAU. Ai është përzgjedhur për të marrë pjesë në garën e yjeve të rinj të basketbollit amerikan Basketball Star Classic. Aktualisht, ai renditet si një ndër 23 lojtarët më të mirë për gjeneratën e re në SHBA, sipas turneut më të fundit. Sina i ri, ishte një ndër më të mirët e turneut Expo-80, duke treguar në Grand Finale se e meritonte për t'u përzgjedhur në elitën e turneut. Përveç këtij sezoni, ai ka luajtur më shumë se 15 ndeshje në një sesion në këtë Divizionin basketbolli. Dhe sipas specialistëve të basketbollit në Amerikë, ai ka një talent fantastik, që i hap atij rrugën e një të ardhmeje të shndritëshme.

Më së fundmi ai kishte treguar, nga ky turne se mund të bëhet nesër një basketbollist i madh në elitën e basketbollit amerikan NBA. Këtë ai e tregoi në turneun kombëtar në Kentaki, ku skuadra e tij për të rinjtë, Hoop Heaven, nga Nju Jersi, në divizionin FAB, për herë të parë në historinë e saj fitoi kupën e kampionit të SHBA, titullin kampion, duke mundur në finale skuadrën tjetër Hoop Dreams, me rezultatin 58 - 50. Mediat sportive thanë se nga ky turne Sina tregoi se do të hyjë si një basketbollist klasi. Ai fitojë të drejtën të studiojë (free) pa para deri në vitin 2013.

Trajneri i skuadrës së të rinjve U15 Hoop Heaven, babai i Jarinit, Mërgimi, tha se "Titulli nuk ishte fare i papritur, bile është pakëz si 'një zvogëlim' i suksesit të kësaj skuadre, që ka disa talente me të ardhme për basketbollin amerikan.

"Ne patëm një ekip më të mirë nga ai i vitit të kaluar, tha ai, por ishim lënë kryesisht si me thënë 'si prapa skenës', nga media dhe specialistët e basketbollit. Këtë vit ne dolëm vetë e thamë se, 'hej, shikoni se jemi edhe ne, këtu!' dhe vërtet e bëmë të na shohin të gjithë", tha ai. Kryetrajneri Sina tha se, "Fitorja ishte pjesë e madhe si rezultat i dominimit mbi kundërshtarin, nga të cilat ne patëm më shumë rebounded (rrëmbime të topit nën tabel) 38 nga 18 të kundërshtarit.

Sina, megjithatë, nuk ishte i habitur! "Kundërshtari ynë ishte një ekip i madh ndër më të mëdhatë që kemi luajtur. Por, edhe ne jemi një ekip që nuk ka frikë për të marrë në turne të tillë kombëtarë dhe kjo është ajo që i bën të gjithë basketbollistët e mij të veçantë. Skuadra jonë ka një ndër basketbollistët e rinj në Amerikë, më të mirin, ai është Dominic Hofman, i cili realizoi 20 pikë dhe kapi 13 rebounds në finale".

"Ai është një talent i madh që bën shumë mirë gjërat në lojë", tha trajneri Sina. "Ai është 'makina e rebounding' në skuadrën tonë". Hofman, tha ai, është lojtari më i gjatë në ekipin tonë - gjashtë inches (2 metra).

Sakaq, media sportive amerikane shkruan se Jaren Sina, basketbollisti tjetër i dalluar i ekipit kampion, është një nga pikat më të forta e të lartë në gjeneratën e të rinjve në basketboll në SHBA. Ai luan si mbrojtës por kalon në ekip, sipas situatave edhe si një qendërmbrojtës dhe vallëzues, pasi ai është shtatëlarë dhe ka shumë vizion në fushë. Ai i shtyn shokët përpara dhe di se si të luajë. Ndryshe nga disa basketbollistët të tjerë, Sina, ka gjithashtu një goditje perfekte trepikëshe nga pozicione të ndryshme, ku skuadra hidhet menjëherë në sulm.

Sidomos, kur ata janë në momente deçizive, kur ai merr "inat", ose siç i themi ne shqiptarët, nxehtet. Sina të befason, ai shtrihet kudo në çdo "pëllëmbë" të palestrës. Ai duhet të ketë edhe disa centrimetra në lartësi kur të rritet dhe të jetë më shumë i kujdesshëm për t'u bërë në të ardhmen, pse jo, "edhe një yll i NBA", kurorës së basketbollit botëror.

Ashtu si shumica e basketbollistëve të ciklit të lartë, Sina, i cili luan me shkollën e mesme dhe sessionin e ardhshëm do të luajë për kolegjet, do t'i duhet të stërvitet e të punojë më fortë. Megjithatë ai synon të arrijë të gjitha vetitë për t'u bërë një basketbollist profesionist, ai ka rënë në dashuri me kërcimin në lartësi nën tabelë, ku atij i pëlqen që t'i kapë topat e parë që kthehen nga tabela. Në fund ai, duke ruajtur mirë pozicionin në lojë si mbrojtës, do të ndihmojë edhe më shumë për të përmirësuar fuqinë e tij, të ruajë atë pozitë të më të mirit në skuadër.

Megjithatë, ai bënë edhe gabime në lojë, thonë specialistët që merren me përgatitjen e tij dhe e shohin me vëmendje talentin e tij. Sina, thonë ata, si kërcyes i mirë gjatë lojës bënë shumë përpara, kështu që ai fillon të krijojë një "vrimë" gjatë ndeshjes, duke menduar vetëm për të sulmuar dhe të konvertohet në disa pozicione e kryejë goditje të ashpra edhe kur në lojë ka "trafik", duke përfshirë fatin e momenteve diçizive të pakën me dorën e tij të majtë "të artë". Jaren gjithashtu e di kur do të përhapet në të gjithë palestrën dhe të japë më shumë duke u lidhur edhe më shumë me lojën e gjithë ekipit të tij.

KALENDARI

"DIBRA 2010"

merr pjesë edhe ti...

tel. 04-2233 283

email: mbotime@gmail.com

Nga: **ABDURAHIM ASHIKU**

(Vijon nga numri i kaluar)

Ikim nga Dibra dhe vijmë në Durrës... Ku e keni hapur dhe hedhur themelin e parë?

Unë realisht e kisha fiksuar se do të isha privat se nuk bën. Arsyja se pse kam filluar punën si privat në qytetin e Durrësit lidhet me pallatin e kulturës të Peshkopisë. Një investitor, një në qoftë se do ta quajmë investitor, i cili ishte nga Dibra e Madhe, Bajram Haxhirexha u bë sepse. Bajrami kishte motrën të martuar në Peshkopi. Pallati ku banonte e motra, e shoqja e Ilir Ramizit, ishte ngjitur me pallatin e kulturës. Atij i kishte bërë përshtypje objekti dhe kërkoi të takohet me mua. Ilirin e kam pas mësues kujdestar në tetëvjeçare, më njihte shumë mirë, më respektonte shumë aq sa edhe unë e respektoja shumë.

Edhe unë e kam pasur mësues të gjuhës shqipe...

Mua më ka dhënë gjuhë dhe lexim...

Unë e kam pas mësues në vitet 1953-1954...

Unë jam shumë i ri. E kam pas në vitet 1968-1972....

Atyre u kishte bërë përshtypje objekti dhe kërkuan të takohen. Shkova në shtëpinë e tyre. Ishin të dy vëllezërit e Dritës. Më thonë se duam të shkojmë në Durrës për të ndërtuar atje diçka. Unë u thashë se jam në procesin e përgatitjes së dokumenteve për veprimtari private në fushën e ndërtimit dhe pres të marr lejen nga ana e gjykatës si person juridik në fushën e ndërtimit...

Më 2 janar të vitit 1992 kemi shkruar në Durrës, kemi parë vendin që ata kishin blerë dhe ramë dakord.

Puna e parë imja në Durrës ishte objekti i Bajram Haxhirexhës, një kompleks shërbimi tek "Vollga". Pastaj ndërtova një objekt të një tetovari, edhe ai lokal. Këta janë fillimet e para të mija në ekonominë e tregut.

Po ajo kulla e bukur në mes të Durrësit kur filloi dhe çfarë pjesë të dashurisë tënde për ndërtimin ke në të?

Te ajo ku banoj sot?

Po, tek ajo.

Kjo godinë është...Unë di të them këtë...Nuk po të lavdërohem. Të gjitha objektet që unë kam ndërtuar kanë qenë më të mirat e kohës. Pranë shkollës industriale kam ndërtuar dy godina që janë godinat e para private, me investime private, shtatë katërshe, të cilat janë bërë në Durrës. Për kohën kanë qenë më të mirat. Pastaj kam ndërtuar dy godina të tjera tek vendi që i thonë "Cirku", një fushë ku montoheshin çadrat e Cirkut Kombëtar, godina njëmbëdhjetë katëshe që për kohën ishin më të mirat. Më pas kam ndërtuar një tek fabrika e bukës, një kam ndërtuar mbrapa serrave tek vetëshërbimi. Kam ndërtuar në Golem, kam ndërtuar gjithandej...

Më tej bleva vendin tek ish URT-ja e vjetër, pallatin për të cilin ti flet. Aty kam bërë më të mirën e mundshme. Kam investuar shumë në fasadën...

Sa katëshe është?

Është trembëdhjetë bashkë me podrumin. Ka një podrum, dy kate shërbimi. Njeri seksion ka në katin e tretë zyrat tona. Pastaj kemi edhe shtëpitë tona...



INXHINIERI PA DIPLOMË ZABIT MUDA...

Përveç këtij kompleksi të bukur ku e ke syrin?

Në qendër jam duke bërë letrat për të marrë një leje ndërtimi afër pallatit ku kam ndërtuar tjetrin. Është më i vogël se tjetri por po insistoj që ta bëj po me të njëjtin cilësi sepse janë ballë përballë njëra tjetrës. Kam shumë sheshe të tjerë në qendër të Durrësit për efekt të studimit për leje ndërtimi.

Do të ikësh ndonjë ditë nga Durrësi për të qenë në Tiranë?

Qejf kam shumë por edhe punë kam pas shumë këtu por edhe atje kam insistuar të kap një vend brenda unazës së vjetër. Dua të bëj vetëm një godinë, ta bëj ashtu si dua unë, të një cilësie më të mirën e mundshme për të hapur punë të tjera.

E veçanta e firmës sonë është se akoma nuk kam bërë ndonjë investim me kapital shtetëror. Më janë ofruar kapitale shtetërore por nuk i kam preferuar...

Emrin firmës ia ke vënë AGZA...

DIBRA – AGZA. Dibra për arsyen që të dinë të gjithë se nga jam, nga vij. Kjo është kryesorja. E dyta AG janë dy gjerat e para të ortakut tim që quhet Agim Islami dhe ZA gjerat e para të miat.

Shoh që ke sjellë edhe blinjtë Peshkopie këtu në lulishtë...

Me të thënë të drejtën jam tifoz i blirit, ndoshta më ka bërë qyteti ku kam kaluar një kohë goxha të madhe të jetës. Për mua ata janë vepër monumentale. Ata, blirët...

Blirët e Agushit...

Të Agush Selishtës, të madhit Agush Selishta, për mua...Unë isha në Peshkopi dhe mbrëmë jam kthyer. Kur shihja disa ndërhyrje nëpër fasadat e pallateve në rrugën "Nazmi Rushiti", një rrugë e veçantë që nuk ia gjen të dytën në Shqipëri, me ato godina simetrike ballë njëra tjetrës, dy e nga dy nga kreu në fund, të një arkitekture, të një urbanistike të veçantë që unë nuk mundur të shoh kund në Shqipëri...Është bërë masakër. Ka ndërhyrje në fasadat. U thashë shqyrr që janë rritur blirët dhe kjo masakër nuk shihet. Për mua blirët e Peshkopisë janë shndërruar në vepër monumentale.

Lamë ndonjë pa kaluar në bisedë? Po, Agim Islamin, ortakun tim.

Cilat janë marrëdhëniet tuaja me Agimin?

Marrëdhëniet e mia me Agimin fillojnë në ditën e parë të punës time në Ndërmarrjen e Ndërtimeve në Peshkopi. Më tërhoqi si person, një njeri shumë aktiv, i hapur, çka më pëlqeu. Nga ky moment u bëra shok me të, punoja me të, ndihmonim njëri tjetrin. Kam kaluar me të shumë, shumë mirë. Kur erdhi puna për të dalë privat nuk desh që të punoj një vit vetëm derisa pashë se pa ortak nuk ecet përpara, duhej një ortak, duhej një inxhinier, një drejtues teknik...

Një inxhinier me diplomë...

Po. Një pjesë njerëzish e kishin zgjidhur duke marrë thjeshtë diploma, lidhje me ndonjë njeri që punonte diku tjetër. Unë nuk e pranova këtë lloj pune. Fillimisht i kam propozuar Sakip Zebit por ai nuk mundi të shkëputej nga Peshkopia. Ndoshta moshja, ndoshta rreziqet e ekonomisë së tregut...

Propozimin e dytë ia kam bërë Agimit...

Kur filluat bashkëpunimin me Agimin?

Me Agimin kam filluar mbas një viti pune. Edhe Agimi nuk e kishte të lehtë për ta marrë. Edhe ai kishte vështirësi për tu shkëputur. Kjo sepse nuk i kishin provuar vështirësitë as njëri dhe as tjetri sa unë. Sepse duhej të krijoheshin kantieri, ndërtesat provizore ku aty gatuanim, aty flinim, aty projektonim. Me një fjalë kushte kantieri por jo si kantieret që kanë qenë në hidrocentrale.

Atje i organizonin të tjerët...

Këtu na duhej t'i organizonim vetë. Kështu nga shtatori i vitit 1992, deri sot, dymbëdhjetë vjet jemi bashkë. Gjithë këto vite nuk mbaj mend kurrë, kurrë, kurrë që të kemi bërë ndonjë debat "pse kështu e pse ashtu", absolutisht jo. Debate kemi pas vazhdimisht vetëm kur luajmë sport. Jemi kundërshtarë të njëri tjetrit për çdo lloj sporti.

Me kë është Agimi?

Kur luajmë bashkë. Për punë ti-

Me të thënë të drejtën jam tifoz i blirit, ndoshta më ka bërë qyteti ku kam kaluar një kohë goxha të madhe të jetës. Për mua ata janë vepër monumentale. Ata, blirët e Agush Selishtës. Unë isha në Peshkopi dhe mbrëmë jam kthyer. Kur shihja disa ndërhyrje nëpër fasadat e pallateve në rrugën "Nazmi Rushiti", një rrugë e veçantë që nuk ia gjen të dytën në Shqipëri, me ato godina simetrike ballë njëra tjetrës, dy e nga dy nga kreu në fund, të një arkitekture, të një urbanistike të veçantë që unë nuk mundur të shoh kund në Shqipëri... Është bërë masakër. Ka ndërhyrje në fasadat. U thashë shqyrr që janë rritur blirët dhe kjo masakër nuk shihet. Për mua blirët e Peshkopisë janë shndërruar në vepër monumentale.

it, folën fjalët më të mira...

Pas disa kohësh më vjen një shoqatë dhe më kërkoi që të ndërtoj një xhami në Sukth. E refuzova. U thashë se nuk bëj xhami tjetër, nuk merrem me këtë punë sepse janë punë të vështira dhe se unë i punoj pa fitim. U thashë se po të doni kam një shokun tim. Më thanë se ne ta besojmë ty sepse ndërtues kemi sa të duash. Përsëri më ofrojnë në Tiranë një xhami tjetër të cilën gjithashtu e refuzova. Pastaj vijmë disa ditë dhe më kapin ngushtë, më thonë se duam të ndërtojmë një xhami në Peshkopi dhe nuk duam të na thuash JO. U thashë se mirë i paskeni marrë masat por edhe unë nuk do tu thosha se nuk e ndërtoj xhaminë në Peshkopi, e kam detyrim shpirtëror. Ata kishin një fond të caktuar, diku tek treqind mijë euro...Ata kishin menduar një vend ku do ta ndërtonin, diku pranë gjykatës. Unë ua kundërshtova si vend me argumentin se objekti të këtij niveli kanë ca norma sepse bëjnë pjesë në objektet sociokulturorë, janë objekte të klasit të parë që zakonisht ndërtohen në pjesë të dukshme në qendër të qytetit. Pas kësaj bëmë një xhiro nëpër qytet, ishim gati njëzet burra. Pamë një vend përballë ish komitetit ekzekutiv, një tjetër tek ish hyrja e divizionit, një vend tjetër që u thash është edhe më i miri, tek Stojket, mes ish maternitetit dhe shtëpisë së ushtarakëve...

Luani bashkë futbolli ?

Ka nja dy tre vjet që nuk luajmë se nuk kemi fuqi por kur luajmë gjithnjë ishim kundër njëri tjetrit, copëtoheshim. Luajmë me letracopëtohemi, luajmë domino copëtohemi...Kundër bëhemi edhe kur ndjekim bashkë ndonjë ndeshje ndërkombëtare në televizor. Ndërsa për të tjerat një fjalë për keq deri sot nuk di ta kemi shkëmbyer.

Marrëdhëniet teknike të punës si i keni?

Agimi merret kryesisht me projektet, unë me preventivat kurse marrëdhëniet zbatuese i kemi të përbashkëta. Kush të jetë i pari shkon tek puna. Gjithnjë kur nuk është njeri tek puna është tjetri.

Kam një fotografi që e kam marrë nga kodra e hotelit të llixhave ku mbi Peshkopi tek Stojket dallohen në ngritjen drejt qiellit dy minare të një xhamie në ndërtim. Çfarë lidhesh ka Zabit Muda me këtë monument të ri kulturi në Peshkopi?

Kjo zanafillën e ka tek xhamia e Pilafes. Në Pilafe nuk ka pas xhami para vitit 1967. Besimtarët e fshatit faleshin në xhaminë e Tominit. Me ardhjen e demokracisë, me rihapjen e xhamive, siç e dini edhe gjyshi, edhe xhaxhai i babait tim, të gjithë kanë qenë besimtarë, baba im arrin dhe blen një nga dyqanet e fshatit dhe e kthen në xhami. Blemë më pas edhe dyqanin tjetër, e shembëm dhe ndërtuam një xhami të vogël për fshatin Pilafe. Xhamia u ndërtua me një cilësi shumë të lartë.

Me çfarë fondesh?

Shumica e fondeve duke filluar nga blerja e tokës, blerja e dyqaneve dhe ca të tjera janë nga ana jonë, imja personale,ndërsa një fond prej nja njëzet milionë lekësh është i një fondacioni që nuk ia mbaj mend emrin në këtë çast.

Kur mbaroi xhamia e Pilafes, në përrurim erdhën nga të gjithë anët, edhe shkëlqesia e tij z. Selim Muça. U bëri përshtypje cilësia e ndërtim-

U pëlqye vendi. Kërkuam se kush është i zoti i tokës. Ishte Ilir Shehu. I telefonuam. Erdhi. I themi se kemi zgjedhur këtë vend për të ndërtuar xhaminë. Ky zotëri që është për tu falënderuar për gjestin e veçantë kërkoi leje që përgjigjen ta jepte të nesërmen. Pas bisedës që kishin bërë si fis kishin vendosur që tokën t'ia falin xhamisë...

Projektin e bëri Agimi dhe ndërtimin e bëmë po ne. Nga ana jonë, brenda fondeve blemë një ndërtesë, ish kursi i partisë, për ta përdorur si shkollë për besimtarët. Godinën e blemë unë dhe Agimi me paratë tona.

Investitorët janë tej mase të kënaqur për cilësinë dhe vazhdojnë të më ofrojnë ndërtime të tjera të cilat unë vazhdoj t'i refuzoj.

Është përruruar?

Përrurimi nuk është bërë akoma, mendohet të bëhet këto ditë, kur të jetë e mundur ardhja e investitorit nga Kuvajti, Dubai apo Katari, nuk e di saktësisht nga është.

Mirë Zabit. Ju faleminderit dhe dëshiroj të ju dëgjoj zërin e mirë dhe të shikoj ndërtime edhe më të bukura.

Faleminderit ju.

Në të 215 faqet e librit "Një jetë mes dibranëve" lexuesi gjen të pasqyruar probleme, kujtime, mbresa e ngjarje, ku pasqyrohet jeta nëpër vite.

Ujëvara e metaforave...

Nga: QERAM CIBAKU

Vjeshtë e vitit 1992. Salla e konferencave e Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës ishte e mbushur krejt. Dëgjohej vetëm zëri i lektorit, një mesoburrë trupshkurtër koreanojugor, Sang Liu, profesor i Universitetit të Nebraskës. Thelbi i leksionit përqëndrohej në reagimin dhe aksionin e njeriut për dukurinë rast. Ja, ç' meritonte të shënohet; Njerëzit në botë dallohen dhe ndahen nga fakti se si e vlerësojnë dhe e shfrytëzojnë rastin. Kategoria e parë: janë njerëzit që e shohin rastin t'u kalojë para hundës së vet. Ata e vështrojnë vëngër dhe mirëfilli e lënë rastin të shkojë në punë të vet... Të tjerë: Një grup njerëzish e studiojnë rastin me kujdes dhe "e gjuajnë" atë duke administruar në favorin e vet, në çastin e vullnetshëm. Këto bëjnë goxha progres. Por ka edhe një kategori tjetër më këmbëngulëse: e presin dhe e kërkojnë rastin, mirëpo ai s' duket gjëkund. Atëherë ata e nxjerrin me thonj rastin nga fundi i dheut! Këta janë amerikanët!- mbylli qetësisht rrëfimin profesori duke shkarkuar mesazhin tek audienca, tek këta receptorë të befasuar që kushe-di se ku bridhnin në hamendësimet e tyre indpendente e krejt të pavullnetshme... Ky pasazh m'u kujtua rastësisht, një ditë kur lexova një libër të Mevlud Bucit. Kështu kurrova një pasarelë dypërnjahje mendimi e latova një paralele me rastin, pasi shkrimtari më kishte thënë se pak libra kishin shpëtuat nga gjuhët e flakës që i kalli shtëpinë e re... Psherëtviva, se kot nuk thonë kot, psherëtviva është shkarkim i zemrës së lënguar. Me ekspresivitetin e ndjeshmërinë e kryefamiljarit, ai si diftong qëndrese e kërkoi jetën dhe e nxorri nga toka e djegur rastin për të filluar (veç jetës) gjithçka dhe një herë nga e para...

Mevlud Bucit ka lindur në Lukan të Dibrës. (Të motshmit cekin se një filozof popullor turk, kishte udhëtuar në vaktin e Turqisë kësaj ane dhe dëftojnë të ketë thënë se " ishte një vend ndërmjet dy kulçedrave (maleve) me gjashtë muaj kallkan (dimër) e gjashtë muaj furrë (vapë) " Por, për ndryshe Mevlud Bucit fluturarakut të fjalës i ve si barrë peshe, plisin e mallin për vendin e brengën e shpirtit atdhetar. "Më vlon në shpirt vullkan dashuria, /Për ty vendlindja ime me shpate e shkrep... Kur turqit-bisha binin drejt Radikës/ Malësorët pritë bënë gjer të Guri i Vashës, / si kala qëndruan bijtë e Grykës, / ndaj tri taborrë iu dërmuan Pashës" Ku nuk u ndje pena e Mevludit. Artikujt e tij problemorë, ciklet e shkrimeve, refleksioneve, esetë e poezitë janë botuar në organe të ndryshme si "Tirana Observer", "Sot", "Rruga e Arbërit", "Dibra", "Ndryshe" etj. Mevludi shkruan vazhdimisht, "rrifet me llaf", u heq koren mjaft realiteteve që shumë syresh nuk u pëlqen t'i trajtojnë se janë si shejtani kur fle... mandej, kaluar na ëmbëlson me poezi, tufa fjalësh ylber, të bëra shuk e të kredhura në puhiza ujrash a thua për t'i mbytur në Setë, Gurë të Vashës, Dri të Zi a kushedi se ku... Më shkrep vetëtimthi në kokë ta lidh kontributin e djersës së këtij shkrimtari me librin dhe i hedh si pelerinë kraheve sentencën Shekspiriane, (sepse i ngjan peri gëzofit): " Sa kohë që njerëzit marrin frymë e shikojnë, aq kohë shkrimet jetojnë dhe kjo të jep jetë TY!".

Mevlud Bucit nuk është vetëm mësues e edukator pasionant, por edhe një drejtues model. Gjithkush që qyq kalvarin e ecejakeve të trazuar të jetës, dallon stërmundimin e arsimtarëve për ta mbjellë indin e vijimit dhe ngadhënjimit të dijes prej vektorëve të edukimit të mësuesve. Më ka munduar shpesh shpërdredhja e zberthimi i nomenklaturës së fjalës së lartë "mësues". Bindem se "English Thesaurus" i mblesh copat e imta të sinonimive, për ta shprehur konotacionin e simbolikën e kësaj fjale. "Mësues-Përgatitës, edukator, ngulitës, instruktor, master, rregullator, normues, trajner, mbikqyrës, këshillues, avokat, pas-tor, predikues, udhëheqës."

Kolektivat pedagogjikë të shkollave Qafmurrë e Lunarë në Dibër; "Ataturk" në Sauk, Laknas, "Sander Prosi", e " Kolë Jakova" në Tiranë nuk e kursejnë fjalën e mirë për këtë drejtues-mik. (Sa



Mevlud Bucit

domethënës është fakti që fjala mik midis dibranëve nuk ndahet ne rrokje...).

"Në këto rradhë po shkruajmë për mësuesin e palodhur Mevlud Bucit, sepse gjithçka kisha degjuar për të, e mësova më mirë atje midis Mësuesvë të Selishtës malore". Ky ishte preludi i shkrimit që mësuesi Sadik Prethi nga Luznia e botoi në një gazetë lokale. Autoriteti, prestigji, komunikimi dhe kuvendimi janë tiparet karakter të plejadës së vet. Si një gjurmues i vullnetshëm, u shqua si mbledhës i folklorit të viseve të Drinit. Andaj populli i Katër Grykëve e propozoi si kandidat për deputet, mirëpo në vend të tij u katapultua Hekuran Isai. Mirëpo ne shpesh bëjmë ujdë me veten, e marrim me të mirë njeriun "rezerve" përbrenda nesh, që ti marrim me pozitivitet disa situata që na i flak egërsisht fati tekta konsumojmë gjallësinë tonë të destinar fatalisht pashmangshëm e ndonjëherë shpërfillur, vec drejtë vdekjes! Ndodh që ngadhënjese nëse do të marrim trenin e largët apo do ti japim duart një miqësie, do të rrotullojmë kokën mbi jastëk mes dënësash apo do të gërhasim në ëndrra të thella dalldisëse, do të ruajmë linjën e moskundërshtimit dhe mosdominimit meqënëse të tjerët janë protagonistë e aktorë të rrezikut që ankorohen në cep të levës së Arkimedit... (Sakaq kafshojnë thonjtë, a në dac fundin e stilolapsit, që destinohet të bëhet preja derivate e dëshpërimit tonë kolektiv, tekta kaplojnë një prej rrateve centrik që bymehen nga truri ynë si inkandishencë e trazuar e syprinave ndijimore të lëmush-ta). Në të tjera herë delirojmë e llastojmë egon tonë të paepur, që fryhet si thupra e shelgut në ujë. Vazhdimisht një pëplasje e mundimshme kalitet në përplasjen e msheftë të modestisë dhe gjithfarë thashethemesh që na rrethojnë në zymtinë e hareshme të ditës. Nën okeljon "shokët tanë, kolegët tanë", gazeta "Mësuesi" në 1977-ën, kthjelltas përshkruan botimin e shkrimit të parë të Mevludit. Ja si e shpreh këtë ndjesi autori Kozma Grillo. " Ka vite që në redaksi erdhi një zarf ku shkruhej: Mevlud Bucit, Katër Grykët. Mevludin nuk e njihnim, kishte nga ne që nuk kishin shkelur në këtë zonë të largët malorë në rrethin e Dib-rës. Vazhdoi të na shkruante dhe atëherë kur nuk i kthjem përgjigje për ndonjë shkrim që nuk pa dritën e shtypit. Na shkruante Mevludi dhe kur në zarf në vend të pullës ishin inicialet "P. U" kur ai kryente detyrën e shenjtë të ushtarit. I dinim emrin, njihnim kaligrafinë dhe zerin e tij, por nuk e kishim parë". E ka shkruar bukur Zef Rozhiani. "Dibrani si gjithë shqiptarët edhe luftën e ka shkruar në këngë". Për 50 vjet nuk i ka dalë koha të jetë aq buzagaz, por vryrtin e ka transmetuar brez pas brezi, e ka ruajtur atë si toka florirrin. Pikërisht këtu e ka lyer penën e tij gazetari dhe poeti i ardhshëm Mevlud Bucit. Gazeta "Mesazheri", bashkëpunëtorin shkencor të Akademisë së Shkencave, e pagëzoi si "princ të poezisë popullore", kurse studiuesi Tonin Doçi pasi shfletoi librin "Thirrje njerëzore", enkas për krijimtarinë e z. Bucit shënoi se "poeti lëmon vargun dhe arrin të shprehë ndjenjat më njerëzore, dashurinë më të thellë për njeriun" dhe se "poeti

bën thirrje njerëz duhet të jemi ndryshe!..."


Rrjeshtat poetikë të poezisë "Piskama e mirësisë" që është në veneracionet e librit "Fari Cam" të Namik Selmanit, i dedikohen poetit Mevlud Bucit: "Hej Mevlud buci, miku im i ëndrës dhe i zgjimit

Mbete piskamë mirësie
Një pendë guri që lëngëzon mall e krenari
Me një stap të vjetër
Vë përpara grigjën e Fjalës së Besimit
Mbush stanet e mcurisë
Gjunjepalodhur, sypambyllur, i paetur për lav-di...

Hej Mevlud Bucit
Bacë i barit dhe i prushit
Me zë zanash dhe magjie
Thuaj për deshe që fjala e zëri yt
Nuk qënka piskamë mirësie..."

Disa shtëpi botuese kanë hedhur në treg 17 libra të shkrimtarit Mevlud Bucit, që janë tashmë në skadat e katalogimit si pjesë e pasurisë kombëtare të Bibliotekës Kombëtare. Libra publicistiko letrarë dhe liriko filozofik: "Udha e mirësisë" (1998), "Thirrje njerëzore" (2001), "Drita hyjnore" (2002), "Foleja e shqiponjës" (2003), "Fletorja e artë e Sandër Prosit" (2004), "Selim Braja i Saukut -shenjtori i lirisë" (2005), "Dritare fisnikërie" (2007) "Fjalor me shprehje e njësi frazeologjike nga Dibra" (2008), "Prova shenjtërie" (2008), "Myftinia e Dibrës dhe Rruzhdhi Lata" (2008)

Nga M. Bucit kanë rezatuar dritën e botimit dhe librat me aforizma "Metafora e shpirtit" (2000), "Ylberet mcurie" (2005). Fabulat e librat satirikë "Krushqia e korbit" (1997), "Koha thërret" (2003), "Diplomatë... diplomacia" (2005). Studimi mbi fjalët e rralla, antologjia publicistiko-letrare "Dritare fisnikërie" ka renditur dhe pasqyruar me detaje kontributet e 150 fisnikëve, një libër që u kushtohet njerëzve që kanë lënë gjurmë diturie. Kur mori flakë e u dogj shtëpia e tij, treçereku i pasurisë së tij (librat) u bë hi. Gabova! Pasuria e tij e madhe është shpirti i dliirë e i paanë i poetit, muza engjëllore e aurorës agut dhe serenata e lirikave të mbrëmjes që ngazëllehët e pikëllohet në rrugzinën e vet, librat e shkruar që gurgullojnë e shprazin ujëvarë me metafora në të grihtën e qiellit. A nuk ju ka bërë pështypje ndjesia e poezisë së tij gjithë sentiment për gruan e tij, kripa e lotit, prelude të flladeve të Pratis, finesat e elegancat e vartur që si besimtarë të bindur përuken drejtë basilikës së tyre, argjinaturat iluministe të mallit, akustikat drithëruese të dashurisë?!... Ersen Çelmeta, nxënës i klasës së 9-të në shkollën "Murat Toptani" e portretizon me këto vargje mësuesin krijues: "Shtetin e tall, ministrit kritikon, /thika s'e pret, gjëmbi nuk e shpon" Në një letër që i dërgon gazetari i talentuar sportiv Defrim Methasani me lakonizëm thotë: " ke qenë, je e do të mbetesh" Çelik Petriti, redaktori i njerit prej librave të autorit përcolli me këto rrjeshta botimin: " Autori Mevlud Bucit shkruan me realizëm, frymëzim e qartësi" Në vitin 2005, kam patur fatin që përgjatë një turi studimor në Hollandë, në kuadër të një projekti të udhërrëfyer nga Zyra e Kontrollit të Përgjithshëm të NAO-s, të vizitoi e prodhimit të diamanteve. Bukur?! Sapo merr në dorë një gur vezullues diamanti të madh sa një kokërr lajthi apo sa një grusht burri të mbledhur shuk) e vërit atë me ndjenjën feminare kureshtare dhe ëndrën e pashpresë të posedimit të tij. Aq!! I vendos smeraldët kristalinë në kutiçka sipas kodeve rigorozë elektronikë dhe i dorzojmë nën vëzhgimin absolutist të syve elektronikë-kamerave. Kaq!! Sapo i kthen kurrizin fabrikës të kaplon një tjetër gjendje: margaritarët brilantë mbeten si imazh i vjetër nostalgjie, ty s'të bie më mendja për to, (sa për borën që ra parvjet!). Ndërsa miku, hareja, bren-ga e fjala e tij mbeten se sa më e vjetër miqësia erzelië, aq më e çmuar bëhet ajo. Prandaj kristalini vezullues të shpirtit filantrop e iluminist të poetit, vlejnë më tepër se ideja subrealiste e posedimit dhe sundimit tundues të një brilanti megakubist që shëndrin e vezullon i akullt e pashpirt, në një sfond të mëndafshhtë vitrine.



Një libër me vlera, një kronikë për vitet e shkuara

Çilido lexues, veçanërisht gazetarët e bashkëpunëtorët e shtypit të dikurshëm, sapo të përfundojnë së lexuari librin e ri të gazetarit veteran e ish kryeredaktorit të gazetës "Ushtima e Maleve" Velo Cfaraku, "Një jetë mes dibranëve" do të meditonte, do të ndjente detyrim të shkruante qoftë edhe pak radhë. Përse? Sigurisht për vetë tematikën e larmishme të shkrimeve, nivelin e lartë gazetaresk, për përmbajtjen e ndërthurjen mjeshtërore të subjektit, për gjetjet e personazheve, trajtimin e problemeve ku lexuesi njeh më thellë jetën, kohën, dibranët, fisnikërinë e njerëzve të thjeshtë, përkushtimin, bujarinë, shpirtin human në shtigjet e vështira të jetës e të kohës. Përgatitja për botim e këtij libri, shkruan autori midis të tjera në hyrje, - e ka zanafillën rreth 40 vjet më parë, kohë kur nisi të dalë gazeta e parë lokale e rrethit të Dibërës "Ushtima e Maleve" prill 1968. Ky libër letrar-publicistik është një vështrim, retrospektiv, harmonik, parë përmes gazetës "Ushtima e Maleve". Edhe vetë titulli, shkrimet e ngjarjet pasqyrojnë jetën, kohërat, njerëzit, fisnikërinë e bujarinë. Autori e nis librin e tij me shkrimin tepër human: "Selim Alliu, "Mësues i Popullit". Lexuesi do të gjejë pastaj një galeri të thellë shkrimesh, mbresash, problemesh, njerëz të thjeshtë, ngjarje e figura të ndryshme. Shkurt libri është padyshim një kronikë e gjallë e jetës dhe e punës në ato vite në Dibër. Të gjitha figurat që autori i ka njohur nga afër, ka punuar vetë me to, i ka sjellë vërtet tepër reale edhe sot pas kaq vitesh tek lexuesi. Por ka në libër dhe shkrime me një tematikë që në ato vite ishin të frikshme si "Pasojat e luftës së klasave", "Debat për një kritikë", "Replikë me një analizë", "Ke nxjerrë sekretin shtetëror". Autori bredh me shkrime në të gjithë gjeografinë e Dibërës se e tillë ka qenë dhe puna e tij në ato vite: Ulet në sofrën bujare dibrane tek Xhetan Tasha në Gjoricë apo në Krej-Lurë tek Bibë Kaçorri. Gazetari veteran Velo Cfaraku ka gdhendur në këtë libër edhe mjaft emra redaktorësh e gazetarësh, bashkëpunëtorësh e korrespondentësh të gazetës së atëhershme lokale "Ushtima e Maleve". Në libër do të gjejmë edhe kullën 300 vjeçare të Bucajve në Armollë apo "Shkëmbi i kuq". Në të 215 faqet e këtij libri lexuesi gjen të pasqyruar probleme, kujtime, mbresa e ngjarje ku pasqyrohet jeta nëpër vite. Është mjaft kuptimplote ajo që midis të tjerave, në fund të librit ish nxënësi i Velos, Hasan Shahini thotë: " Tek libri i Velos secili prej nesh gjen vetveten, me episode, emra, foto... " Duke përfunduar edhe unë ish bashkëpunëtori më i rregullt i gazetës "Ushtima e Maleve", ku kryeredaktor ishte Velo Cfaraku, më duhet të uroj autorin e këtij libri: "Faleminderit, o Velo Cfaraku, biri i Gjinovecit të Gollobordës së Dibërës!

Mevlud Bucit

Muri me gurë shumë të mëdhenj në trajtë blloqesh i Akropolit të Athinës është ndërtuar nga Pellazgët dhe emërtohet "pelargikon" apo "mur pellazg", të cilën e dëshmojnë një varg autorësh antikë e arkeologë të shumtë.

Dritë diturie në shekujt e errët

Nga: Dr. SELMAN MEZIU

(Vijon nga numri i kaluar)

SHTJELLIMI I SË VËRTETËS MBI PELLAZGËT

Për të zbuluar të vërtetën mbi PELLAZGËT si një popull parahelen e banorë fillestar i hapsirave Ballkano-Danubiane e të Egjeut, të cilët i kanë dhënë qytetërimin Europian mjaft elemente të kulturës së tyre, autori shfrytëzoi me kujdes e zgjuarsisht shkrihtarë e historian të lashtësisë si Herodoti (484-425 p.e.s.), Helanikos i Mitilenit (Shek.V.p.e.s.), Homeri (800-750), Tuqididi (460-395), Hesoidi (rreth vitit 700 p.e.s.) Hekati i Miletit (560-480 p.e.s.) etj.

Gjithashtu janë studiuar e hulumtuar me këmbëngulje e maturi në disiplinat shkencore të Gjuhësisë, Historisë, Arkeologjisë, Antropologjisë, Poemat epike e Mitologjitë. Tekste e dokumente të lashta latine, egjiptiane, hitite, ugaritike, hebraike, si dhe të Biblës, Testamentit të vjetër Ebraik "Kuranit", "Ungjillit", etj. Duke nxjerrë, zbuluar nga ato të vërtetën "të zhytur në pellgun e harresës së qëllimshme, që Grekët ishin më të lashtët se origjina e tyre ishte pastërtisht Europiane. Siç iu mveshën nëpërmjet historianit grek Dionisi i Halikarnasit, Romakëve origjina Greke, sepse sipas tij e pasardhësve të mëvonshëm, do të ishte fyerje, poshttrim, përlulesi që ata të kishin zanafillën Pellazge siç na e bën të njohur qartë e bindshëm Arefi në dhjetra faqe.

Muri me gurë shumë të mëdhenj në trajtë blloqesh i Akropolit të Athinës, është ndërtuar nga Pellazgët, dhe emërtohet "pelargikon" apo "mur pellazg" të cilët e dëshmojnë një varg autorësh antikë e arkeologë të shumtë. Po kështu edhe emri Athinë nuk shpjgohet në gjuhën greke, ndërsa falë shqipes ajo fatmirësisht shpjgohet "premtim" në gegerisht "e thana" dhe më tej "e thëna". Dhe më shkukur qytet "i premtuar" i Pellazgëve.

Thesalia ka patur si kryeqytet Larisen, e cili gjëndet edhe sot, e domethënia e saj është: "kalë i përhimtë apo larosh" apo fjala "lar" do të thotë edhe "mbret" etj., i krijuar nga populli Pellazgë. A nuk krenohen grekërit me qytetin Argos si më të lashtin e tyre, por mjerisht atje kanë banuar Arkaditët e Argianët, nga ku kuptohet lehtë zanafilla e emrit të këtij qyteti. Edhe ky përfundim është arritur falë teksteve të lashtësisë e analizave të gjetjeve arkeologjike.

Qytetërimi KRETAS është i mbështjellë me një mori pikëpytjesh. Ja të shohim se ç'farë të vertetash na zbulohen duke lexuar historinë në fjalë. Bënin pjesë në bashkësinë e popullit Pellazge, Kyretët apo Kuretët, ato ishin rojet e ZEUESIT – fëmijë dhe ishin banorët e parë të Kretës, natyrshëm rrjedh emërtimi i këtij ishulli (Kuretë = Kretë). Kulmin e qytetërimin të saj e arriti në vitet 2200 (p.e.s.) që u quajt Mioniani i Lashtë. Gjurmët e shekujve, të materilizuara në jetën ekonomike, politike e kulturore, me anë të fosiljeve të natyrave të ndryshme të gjtura, e të studiuar janë dëshmi e patundshme.

Falë gabimit të Aristotelit se Dorianët vijnë nga veriu i greqisë, ata edhe sot e kësaj dite e shohin Epirin si djepin e origjinës së tyre. Por në antikitet (XII-VII p.e.s.) kjo krahinë quhesh Pellazgi e në shekujt e mëpastajm THESPROTI (Homeri, Herodoti) e në vazhdim Epiri i cili në pellazgo-shqipen shpjgohet: Epër. Epëri, dhe në kuptimin më të gjërë mund të shkruajm "vendi i Epërm" pra që gjeografikisht gjëndet mbi apo përtej Greqisë.

Ne lashtësi Thrakët, Thesprotët, Ilirët e Boetianët kishin si emërtim gjeografik EMAT. Në kuptimin gjuhësor brënda së cilës ka rrën-

jën "Madh" është tashmë kuptimplote të jetë e barasvlefshme me "E Madhia" e banuar nga Pellazgët. Janë këto që i vendosën një emër të tillë për shkak të kullotave me sipërfaqe të mëdhaja, të paanë. Ndërsa emërtimi Macedoni është përmendur në periudhën e Greqisë klasike (478-336 p. e. s.) Kjo hapsirë shumë e gjërë toksore, ishte e ndarë në principata e mbretëri të cilat kishin marrë emrat sipas popujve apo udhëheqësve të tyre si Pelagonia, Elimeia, Orestida, Pagonia, Pieria, Linkestida etj. Deri në luftën e Peliponezitetit (431—404 p. e. s.) ata ishin një popull Barbar. Udhëheqësit e tyre filluan të përthithin gjithë kulturën – politiko e shoqërore të helenëve, e më pas popujt u asimiluan në të njëjtën mënyrë.

Filistinët ishin një poull Pellazgo-ilir, nga veriu i Greqisë klasike ku gjëndet një qytet me emrin Palaiste ose ndryshe Palaest. E pikërisht nga këto vende Filistinët shteguan drejt Qipros, Siçilisë, Kretës, Egjiptit së fundi u vendosën në jugun Fenikias duke krijuar vedbanimet reja Gaza, Ashdod, Gath, Ashkalon dhe Ekron, ku të gjitha së bahku u emërtuan "Paleshtim" të cilat me kalimin e shekujve u zgjeruan duke formuar PALESTINEN e sotme.

Emri i Greqisë dhënë, emërtuar nga Romakët është marrë nga një fis pellazg Graikos, poemat e Homerit ishin rapsodi të traditës gojore të popujve pellazgë, dhe herojt që gjënden e veprojnë brënda veprës janë të tyre, si Akili, Ulisi, Agamemoni, Praimi, Heleni, Hektori, Kasandra Enea etj, domethënia e tyre mund të shpjgohet shkëlqyer falë gjuhës shqipe, e vetmia "fosile e gjallë" mbijetuar nga tajfunët e pamëshirshme të shekujve.

NË HULLINË E HULUMTIMEVE

Me zgjuarsishtë pashoqe, me gjuhën plot lajka të shkrihtarëve, historianëve, poetëve me krenarinë e paskrupullt të politikanëve, grekërit mohuan gjithçka të trashëguar nga qytetërimi PELLAZG, dhe rishkruan historinë duke filluar nga barka e Noes së tyre. Maskën e tyre, filluan ta gërvishin dalëngadalë edhe studiues shqipëtarë e albenologë të ndryshëm. Profesor Jeronin de Rada në vitin 1864 boton studimin "Antikiteti i kombit Shqipëtar dhe afërsia me Helenët e Latinët" prej dyzet faqesh, i cili duke përdorur me plotë mjeshtri e argument shkencor të njëjtin "çelës të artë" gjuhën e stërllashtë shqipe arrin të zbulojë në shume fjale greke e latine origjinën e tyre nga Pellazgjishtia.

Me një punim serioz, dhe papritmas në vitin 1903, ADAMITI e titullon punimin e tij "Pellazgët e pasardhësit e tyre Shqipëtarët". Më qartë e shkoqur nuk mund të shprehesh e shkruante ndryshe.

Publiçisti e historishkruesi me prodhimtar Italian, Viko Mantegaca në librin e tij "Turqia liberale dhe çështia Ballkanike" botuar në vitin 1908, iu kushton disa faqe prejardhjes nga gjeneologjia pellazge të Ligurëve, Me-


sapëve, Japingëve, Liburnëve e Venetëve etj., e shpjgon me të njëjtën metodë prejardhjen nga pellazgo-shqipja të emrave si të qytetit të Brindësit, të ishullit grek Korfuzit të rruges Egnathia etj. Edhe ky autor shfrytëzoi literaturën greke të kohës klasike, franceze, italiane, gjermane të këtij fillim shekulli për të argumentuar sa më bindshëm tezën e tij mbi popujt Pellazgë.

Studiuesi e politikani i gjysmës së parë të shekullit të njëzet Mid'hat Frashëri në studimin e tij "Notë gjuhësore – arkeologjike" shkruar në Gjenevë më 2 Shtator 1920, merr në analizë fisin Brygas i cili emigroi në Egjipt, dhe grekërit iua ndërruan emrin në Fryges. Platoni thotë për ato se gjuha e tyre ishte e njëjtë me atë të Maqedonaseve. Duke shfrytëzuar autorët e lashtë grek Romak ai shkruan për fjalën Burrë e Pyrron, Epirin, Sekuliotët, çanones (çamërit) Mollosët, Am-flokës Ambrekes, The-sprotes të lidhur ngushtësisht nga pipamja, gjuhësore, etniko-kulturore me trungun PELLAZG. Po ndalemi te një tjetër studiues e mendimtar shqipëtar, Mehdi Frashëri i cili në pjesën e parë të historis së përgjithshme të Shqipërisë, nga faqja pesëdhjetë e një deri në gjashtëdhjetë e nëntë ia kushton Pellazgëve, Historia dy volumshme e Mathieut ngjanë si dy pika uji me atë të mësipërmen, ja si shkruan ai: "Doktor Haani (Johan Georg von Hahn) që ka bërë shumë studime dhe kërkime mbi shqipëtarët, pranon këtë mendim, d. m. th që shqipëtarët e sotëm, janë drejtëpërdrejtë bijë të Pellazgëve. Luis Benoliev, Felix Zhulieni, Sami bej Frashëri dhe Profesor De Rada janë në mendjen e Hanit. Shpjgon fjalët Trieste, Dalmacia etj me origjinën në gjuhën Ilir-Shqipe".

Në vitin 1974 botohet për herë të parë në frengjisht "Historia Shqipërisë nga origjina në ditët tona" autorët e së cilës janë baballarët e historigrafisë shqipëtare Stefanaq Pollo, Arben Puto, Kristo Frashëri dhe Skënder Anamali. Çështjes PELLAZGE ato i kushtojnë vetëm tetë rreshta, ndërsa origjina e ilirëve na vërtetohet se vijnë, rrjedhin, e kanë prejardhjen nga Polonia perëndimore e pikërisht nga LUZAKIA. Sa keq, edhe kur mendon që shumica e tyre kanë kryer studimet universitare në Austri. Fatqësisht, paradokset e bëmave shqipëtare të kësaj periudhe nuk kanë kursyer as histori shkruesit.

Në fillim shekullin të njëzetë e njëjete, historigrafia e re Elena Kocaqi paraqitet përpara lexuasve e studiuesve shqipëtar me punimin "Roli pellazgo-ilir në krijimin e kombeve dhe gjuhëve Evropiane" duke shkatërruar me inteligjence e punë të mirëfilltë, kërkimore shkencore akullnajën dyzetë e pesë vjeçare të teorive thellësisht të gabuara të koncepteve e ideve të errëta e mjegullnajë mbi historigrafine e gjeografine PELLAZGE.

Të gjitha këto krijime të shkencës historike, në kalvarin e rreth një shekulli përbëjnë gjer-



danin e shkëlqyer të njohurive, diturive, fakteve, provave kryeneçe që Shqipëtarët janë pasardhës të drejtëpërdrejtë të popullit të stërmadh në numur e hapsirë gjeograike të Pellazgëve, pasardhës të pastër etnikisht kanë mbetur SHQIPETARET brënda jashtë kufijve të sotëm.

* * *

Lisi antik, i shenjtë për Pellazgët, në Dodonën e kultit të tyre fetar i kishte shtrirë rrenjë të tij të fuqishme që nga rrafshnalta e Anadollit, në ngushticën e Helespont (Dardanellet) në Joni (Azi e Vogël), ishujt Egje, detin Jon (Mesdheu), Kretën, Qipron, në Peleshti (Palestinë), Egjipt, Gadishullin Iberik, Apenin (Italik), Spineta (lumi Po) gjirin Jonian (Deti Adriatik), e ngjitemi më në veri e pikërisht në Hallstat (Austri), Kolonje (Gjermani) në rrjedhjen e poshtme e të sipërme të Istrias (Danubi) ngjitemi në Kaukaz, e përfundojmë në detin Pont-Euksin (Deti i Zi). Madhështia e degëve të tyre plotë jetë, krenari mbanin fiset Pellazge etnikisht të pastra, autoktone dymijë vjet para se të vinin Grekërit si: Thrakët, Brigët, Dardanianët, Ilirët, Panonianët, Dasaritët, Autariatët, Paonianët Molosët, Sikulët, Iberët, Etruskët, Kaonët, Tirrenët, Pelagonët, Lidianët, Japigët, Enetët etj. Histori – gjeografinë e tyre, e qëmtoi, e mblodhi me durimin e pasionin e një mendimtar të madh Aref Mathieu duke e ngritur në pedestalin që e meritonte. Por ky lis teje shekullor duhet ushqyer vashdimisht, nga historian e gjuhëtar, etnograf e arkeologe, shkrihtar e poetë, folklorist, skulptor e piktor, politikanë e parlamentarë, emigrantë studiues në çdo vend qofshi, me limfen e DIJES, për të mbetur gjithmonë i gjallë, madhështor e krenar duke realizuar gjithashtu ëndrrën e albanologut të madh gjerman Karl O. Muller të shekullit të nëntëmbëdhjetë i cili pati shkruar "Me sa më shumë INTELIGJENCE të depërtohet në historinë e Greqisë aq më shumë e vëmendje do ti kushtohet elementit Pellazg deri tani të SAKRIFIKUAR".

Firenze 05. 02 2009

LITERATURA:

Mathieu Aref: Shqipëria (historia dhe gjuha)
Mathieu Aref: Odisja e pabesueshme e një populli parahelen. Tiranë. Plejad 2007
Mathieu Aref: Mkenët – Pellazgët. Greqia ose zgjidhja e një enigme. Tiranë. Plejad 2008
Elena Kocaqi: Roli pellazgo-ilir në krijimin e kombeve dhe gjuhëve evropiane. Tiranë "Dajti 2000" 2007.
Mid'hat Frashëri: Elita shqiptare. Tiranë, Plejad 2008
Vico Mantegazza: La Turchia liberale e le Questioni Balcaniche. Milano. Fratelli Treves, editori 1908.
Mehdi Frashëri: Historia e lashtë e Shqipërisë dhe e shqipëtarëve. Tiranë. Foenix 2000
S. Pollo. A. Puto: Histoire de L'Albanie, des origines a nos jours. Roane. Horvath 1974
Girolamo De Rada: Antichita della nazione Albanese, e sua affinita con Elleni e i Latini. Napoli. Largo S. Marcellino, 2 1846.



mer
kopjen
tënde

Bëhuni
pjesë e
gazetës!

E-mail: rrugaearbërit@gmail.com.
Tel. (04) 22 33 283 / 068 31 19 232
www.dibra.org

Koha si kosto e lartë e reformave integruese

Nga: **HYSEN UKA**

(Vijon nga numri i kaluar)

Fakte të tilla ka aq shumë dhe kudo nëpër Shqipëri, për të cilat nuk është i mjaftueshmë dhe nuk do të rinin mirë në formatin e këtij shkrimi. Ka edhe "memorie statistikore" të stacionëve të asaj kohe, puna e të cilëve përhirë të së vertetes duhet thënë se ka qenë skrupuloze dhe profesionale. Mendoj, se tashme ka ardhur koha ti nësh-trohen llogjikës shkencore të studuesve, faktet dhe fati i tyre (i fakteve) të asaj periudhe, dhe në kontekstin e ngjarjeve të kohës, të nxjerrim mesimet e duhura se çfarë duhet të kishim bërë më mirë apo ndryshe. Po nën atë frymëzim, gati sa nuk u shkruajt në qiell se: "prona private është e shenjtë", por asnjëherë dhe nga as kush nuk u tha se në vendet e demokracisë liberale edhe "prona publike (e grupit apo e ashtuquajtura socialiste) është e pa prekshme", por jo e "pa ndashme" me rregulla e sipas kontributeve, ashtu siç ishin shembujt e vendeve të tjera që kishin hyrë në të njëjtin kurs reformimi. Nuk mendoj se mund të jeshë kampion i lirisë së pronës private, duke frymëzuar shkatërrimin e pronës publike, nga e cila burojnë të mira për grupin shoqërorë (komunitetin) apo për të gjithë shoqërinë, e njëkohsisht edhe të mira vetjake. Asnjëherë dhe askush nuk bëri një inventarë të asaj çfarë kishim ndërtuar e që duhet ta ruanim, përshtasim e ta përditësojmë në sistemin e ri ekonomik. Ne nuk ishim një popullsi që dilnim nga shpellat, ne nuk kishim bërë vetëm qendra zjarri, edhe pse prej tyre kishim bërë aq shumë, por kishim bërë edhe gjëra tjera shumë të vlefshme, të cilët bunkeret nuk duhet të na zinin sytë për t'i bërë vlersuar. Ne kishim një industri ushqimore që në atë kohë binte të ardhura nga eksporti në buxhet, sa gjysma e të ardhutave nga industria minerare, e cila mund të përshtate mirë dhe mund të ishte bërë shpejtë konkurrencte. Ne kishim një puntori të kualifikuar, të aftë për sipërmarrje e punë në shumë sektorë të ekonomisë... Por duhej ngritur e gjithë kjo stih, që dikush të legjitimonte, për mes eksperimentit me shoqërinë dhe ekonominë tonë, teorinë e tij (të gatuaran me ideologjizma, akademizma, politizim); që dikush të shkatërrojte sistemin tonë të prodhimit për t'i bërë shqiptarët konsumatorë të varur nga tregjetat e vendeve fqinjë, qoftë edhe për produktet e tregut të gjelbert.

Pra, është me vend që ne ta rishohim me sy të ftohtë nisjen tonë, për të kuptuar çfarë bëmë keq, kush e deformatoj projektin tonë të reformimit dhe çfarë duhe të rregullojmë. Sa kohë ne nuk kemi bërë këtë, i mbetete e drejta aksidentpolitike (në mesin e së cilës fshihet edhe aso llojë politikanësh, të cilët më shumë kanë qenë e janë të peokupuar për të shërbyer si agjent tregtare të ekonomive rajonale), të gatshëm për të mos humbur rastin për të derdhur herë pas here ujra të pista në damaret e ekonomisë e të zhvillimit tonë, duke e bërë atë të tështij apo edhe të lëngoje, se sa politikan që janë të angazhuar në shëndoshjen e vizionimin e saj.

Edhe problemet e rënda që kemi me pronësin mbi tokën janë pasojë e asaj nisje të frymëzuar nga e keqja dhe jo nga ndjenja e përdorimit dhe e begatimit të tokës. Kur sheh se si është masakruar e keq përdorur toka tek ne, bindesh se djalli vetë e ka kurdisur prapsinë në ndarjen e përdorimit e tokës sonë, me qëllimin që shqiptarët, në mos u vrafshin midis tyre për një "pëllëmbë tokë", të paktën ajo të mos rregullohet kurrë, t'u mbetete përgjithmonë litarë nëpër këmbë, e jo thesar ne dorë, siç është në të vertet. Po krijove problemin e pronësisë mbi tokën, ke krijuar mjaftë probleme në një vend, në të gjithë sistemin ekonomik-social, e ke futur zhvillimin e tij në qorrsocka, për kohë të gjatë. Ky është një problem tepër serioz, i cili mbetet i pa prekur dhe i pa zgjidhur ende sot, pas kaq viteve reforma e ristrukturim të ekonomisë, një problem që politika e përdorur si mjet, e qeveritë nuk guxojnë ta hapin "kutin" e saj.

Pra, në gjithçka dhe në çdo gjë, duhet filluar me llogaritjen e kohës. Sa kohë me mori kjo punë, kjo reformë, kjo ide, ky projekt, ky shok, ky mik, ky njeri... dhe sa vlejti koha që ju kushtova. Kohën edhe pse e kemi aq të kufizuar, e shpenzojmë aq pa kujdes.Koha nuk ka trajtë lëndore, t'i nuk e sheh as kur hynë as kur të del nënë lekurën tënde, por e kupton kur thinjesh apo

■ Ndërsa ne shqiptarët mbetemi në platformën e stacionit, duke qarë e sharë paraardhësit, të kaluarën që nuk qe e mirë me ne, që na dënoi me komunizëm, ndërsa treni i vendeve vrullon përpara.

rrudhesh prej saj. Ashtu pa u ndjer koha hynë e del edhe në jetën e popujve, kombeve dhe ato që e çmojnë dhe e trajtojnë mire jua lë duar plotë e në begati, ato që e se çmojnë e nderojnë, koha ju vidhet, ju ikën nëpërduar, duke ua marr edhe atë që mund të kenë patur, duke i lënë duart bosh. Po kohën tonë kush e shpërdoroi.....?! Koha s'është lënë jashtë vemendjes asnjëherë, çdo analizë duhet filluar me kohën, sa dhe si e kemi përdorur, duhet të parë si element i pa shmangshëm dhe themelor i çdo kostoje. Ajo çfarë nuk bëmë i mirë dje, është kosto e së ardhmes. Ta shohësh kohën si kosto (se kosto nuk është vetëm shpenzime për njësi prodhimi dhe të ardhura për njësi shitje, por duke futur edhe njësitë e kohës gjatë së cilës ndodh çdo veprimtari prodhimi e proces qarkullimi. Pra, duke parë kohën e shpenzuar për njësi zhvillimi, dhe po të shtosh kësaj kostoje edhe zhvillimin e munguar, kupton se kemi paguar shumë shtrenjtë për trazicionin tonë. Në të gjitha këto thyrje e rrokullisje që kemi kaluar, ende nuk kemi mësuar se kush na e vuri stërkëmbshin dhe ku gabuam, a po ku qemë të pakujdesshëm. Sa kohë nuk kemi mësuar këtë, ne jemi të pa sigurtë dhe me zemër të ngrirë se kurthe të tjera na presin. Duke e parë në mënyrë diakronike procesin e ristrukturimit dhe të reformimit të vendit tonë, elementi që kemi shpenzuar më shumë dhe më me pak efektivitet është koha, koha është "malli" që shpërdorojmë më lehtë, "malli" që shesim qesim, pa e peshuar, pa e matur, kuturu. Edhe në marrëdhëniet personale, a kontrata politike, kur vemë kohën në mesë gjithmonë, shprehemi në mënyrë të papërcaktuar e të pa kursyer: "rreth orëve...; brenda aq e kaq ditëve; për dy a tre vjet; brenda mandatit të parë e një pjesë të mandatit të dytë..." etj. Ato që projektojnë të ardhmen tonë, ato që hartojnë programe për zhvillimin e vendit, kujdesen gjithmonë që të lënë pezull dy kolonat e fundit të premtimeve të tyre, ato të afateve kohore: "nga ..., e deri më" Koha jonë na fshihet që në planifikim, ato që duan të fshihen përdorin kohën për këtë.... Program-bërsit sillen me kohën si ujuku me prenë, të për-lajmë ç'të mundemi, sepse nuk ju kërkohet dhe nuk japin llogari. Qesimi më i madh i politikës sonë është koha, për të cilën asnjëherë dhe nga askush nuk u kërkohet llogari. Qytetarët edukohen që të mjaftohen vetëm me justifikimet, tashmë e steriotipe, si:u përpoqa..., do të përpiqemi...., u përpoqem... shpresojmë në të ardhmen...etj. Nuk ke të ardhme, nëse le të të ik e tanishmja, e sotmja.

Ka një rrafsh konkret ku mund të bindemi, bile edhe të alarmohemi për këto shpërdorime dhe spekulime me kohën. Po të analizosh kohën e konsumuar për ndërtimin e sejcilës nga ato aq veprat sa janë ndërtuar në vendin tonë, do të gjejshë si të përbashkët se asnjëra nuk është përfunduar në kohë, dhe për kohën e shpërdoruar nuk është ndëshkuar, apo nuk ka dhënë llogari askush... (rasti i rrugës së Arbërit... nga promovimi i nismes (nevojës) prej qytetarëve, pranimi nga qeveria dhe bërja e fizibiliteti, projektimi e fillimi i ndërtimit, koha e shpenzuar dhe gjendja aktuale e punës së kryer, vjen në përfundimin se me këto ritme duhet edhe 50 vjetë që vepra të përfundohet; e çdo të vlej atëherë kur njerzimi duhet të ketë shpikur forma dhe mjete të të tjera komunikimi e lidhje) Apo projekte të tjera publike, korridore, HC, autostrada etj... shumica e të cilave ende janë në ajër, e qytetarët presi..... Duke analizuar këto raste e plotë të tjera në të gjitha fushat e zhvillimit ekonomike e social- kulturore, kupton se sa shtrenjtë na ka kushtuar kjo pakë rrugë e zhvillimit, se Shqipëria ka ecur përpara me këmbë të lidhura apo të thyera. Për këtë "kohë e humbur", e cila është jeta e njerzëve tanë, jeta e kombit tonë, askush ende nuk e ndjenë detyrimin

jep llogari. Është bërë e zakonshme që ata të cilëve ne u " dhurojmë" vullnetin për të na qeverisur asnjëherë nuk na vijnë në llogaridhënie; ata rreket vetëm të gjejë shallin e zi, të na lidhinë sytë, për të mos parë çfarë ka ndodhur, e për të dalë duar larë në fushatën elektorale të radhës. Për të shijuar frytete e zhvillimit (zhvillimore) të "vizionarëve "tanë të politikës nuk është e mjaftueshme një jetë e zakonshme njeriu, por do të duhet të rrosh 200-300 vjetë për udhëtuar në rrugën që të premtton, për dalë nga lista e pritjes për punësim, për tu çlodhur në parkun që garantonë, për të jetuar e pushura si një qytetar europian e për çdo vlerë tjetër që bashkëeuropianët tanë, të cilët në të shkuarën e tyre, po ashtu si ne janë rrënuara nga luftat, nga ideologjitë, kryqëzatat etj, por kanë ditur të ringrihen të kapin kohën e realizojnë zhvillimin.

Analizat e thella për kohën e humbur e zhvillimin e munguar shkundi nga plogështia e amullia gjithë lindjen europiane duke e shëndrruar në një lëvizje të fuqishme për nryshim, ritme të shpejtuara zhvillimi e e integrimi duke u kurorëzua brenda një afati normal vende komunitare të Europës. Natyrishtë që proceset e integritimit dihet se karakterizohen nga dy tipare, se janë procese relativisht të gjata që, nuk realizohen në një ditë, duan kohën e nevojshme dhe një tipar tjetër, që është gradualiteti. Proceset e integritimit të Shqipërisë kanë tejkaluar konsumin e tiparit të parë duke qenë jo vetëm të gjata, por të "stërzgatura", dhe për pasojë e ka pësuar edhe tipari tjetër, gradualiteti, apo temporitmi.

Të shohim shkurtimisht gradualitetin (temporitmin) në rrugën e reformave, drejtë integritimit në BE. Deri në vitin 1996, Shqipëria ishte shteti më i avancuar i Evropës Juglindore në raport me Bashkimin Europian. Me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike në vitin 1991 me BE shqipëria nisi një rrugë interesante në procesin drejt integritimit të strukturat euroatlantike. Gjatë periudhës 1991-1994, pra, në fazën e parë humanitare, Shqipëria fillimisht më 11 maj 1992 nënshkruajti marrëveshjen e tregtisë-bashkëpunimit, e cila hyri në fuqi me 1 dhjetorë 1992, ndërkohë që vazhdon të shfrytëzoi fondet nga ndihmat emergjente të ECHO. Pastaj, nga fillimi i vitit 1994, Shqipëria kishte shfrytëzuar fondet nga programi PHARE deri në trazirat e vitit 1997. Nga programi PHARE deri në vitin 1996, Shqipëria ishte shfrytëzuesi më i madh i fondeve të tij për frymë, ndonëse me përjashtim të Moldavisë, kishte GDP më të ulët në Ballkanin Perëndimor: vetëm 708 dollarë amerikane. Kjo sipas Elke Thiel: Aspektet ekonomike të afrimit të Shqipërisë me BE-në ("European Integration of Albania, Economic Aspects), Tirana 2004. Shifra që shënon nivelin e GDP së Shqipërisë për periudhën e dhënë është korrekte, dhe nuk mendoj se mund të ketë diskutime rreth objektivitetit të saj, por ndoshta duhet të plotësohet edhe me disa referenca kohore të tjera, para apo më pas, për të përcaktuar ëshkaqet e rënjës së menjëherëshme, dhe të vendoset rendi sa "rrëzimi i GDP" që për shkaqe subjektive dhe sa per shkaqe objektive.

Shqipërisë në dy konferencat e donatorëve të BE-së në Bruksel u dhanë edhe mbi 500 milionë Euro. Nga fillimi i vitit 1994 e deri në shtator të vitit 1996, Shqipëria kishte shfrytëzuar gjithsej 1.997,235 ECU. Llogaritet se deri në shpërthimin e trazirave në vitin 1997, Shqipëria ka qenë ndër vendet që ka shfrytëzuar dhe përfutuar më shumë nga të gjitha vendet tjera fonde të BE-së. Kjo sipas: "The European Union's Phare and Tacis Democracy Programme". Projects in operacion 1996, Brussels, 1996. Në aspektin institucional të marrëdhënieve me BE-në deri në vitin 1996, kur pritej shqyrtimi i marrëveshjes për asocim, meqenëse Shqipëria kishte përfunduar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me BE-në dhe pritej që madje, në fillim të vitit 1997 të fillonte edhe negociatat për Stabilizim dhe Asocim, si i pari vend i Ballkanit që i jepej shanci për të hedhur këtë hap aq të rëndësishëm; Shqipëria kishte patur një ritëm të lartë reformash. Kjo ishte ajo çfarë ofronte Shqipëria e parë me dashamirësi nga jashtë, ndërsa brenda cilësia dhe mënyra arbitrare se si po bëheshin reformat nuk premtonte se do të siguronin për shumë kohë mbështetjen e popullit. Mungesa e vullnetit për të komunikuar dhe ndarë efektet si ato pozitive dhe ato negative, me

të gjitha shtresat shoqërore, duke kërkuar rrugë e mjete efektive dhe pa shkaktuar trauma e vuri pushtetin e asaj periudhe në kundërvernie me popullin gjë që pasoi me rëzimin e madh të 1997. Humbja më e madhe nga ajo çfarë ndodhi në Shqipëri ishte humbja e besimit dhe zgënjimi që u bëri politika e mbrapsht aleatëve dhe mbështetësve tonë dhe ritmi i humbur që nuk kapej më. Prof. Dok. Charl King, në fjalën e tij në seminarin e Institutit të Studimeve Strategjike, mbajtur në korrik të vitit 2000, në Tiranë ka thënë: "Nëse gjatë viteve 1994-1996 Shqipëria shikohej si favorite për t'u anëtarësuar në NATO, ngjarjet e pranverës 1997 shuan shpresat për një anëtarësim të mundshëm asociativ,pas krizës 1997-99, Shqipëria ngeci dukshëm pas vendeve të tjera të rajonit. Botuar në Revisten Ekonomia.

Të gjitha ato çfarë ofronin për Qeverin shqiptare të asaj kohe, SHBA dhe institucionet europiane ishin një ofertë speciale, që synonte integrimin e shpejtë të Shqipërisë dhe shndërrimin e saj në një shembull integrimi dhe pikë mbështetje në rajon për të garantuar paqen dhe proceset e demokratizmit të vendeve të Ballkanit.

Zëvendësimi i besimit tek institucionet publike me besimin tek lideri (lideri i fuqishëm karizmatik, demokraci sjellësi, etj, etj) nuk mund të vazhdonte për një kohë të gjatë. Nga anatjetër mungesa e traditës së zëvendësimit të lidërve dhe kalimeve të pushtetit siç shprehet përmes zgjedhjeve publiku, me rrotacion politike, paqësishtë prodhojnë konflikte të rënda dhe humbje të thellë të besimit edhe tek institucionet. Analisti Vojtek Lamentovic e quan këtë "paradoksi i mosbesimit", që shfaqet në shoqëritë në tranzicion. Lamentovic shkruan: Lindja e mosbesimit riprodhon deficite besueshmërie ndërmjet elitës në pushtet dhe qytetarëve cka mund të cojë në krizë legjitimiteti.... konsum emocional të njerzëve të cilët prirën të mos besojnë më tek institucionet e të ndodhin shpërthime të pa parashikuara"

Ndërsa ne shqiptarët mbetemi platëformën e stacionit, duke qarë e sharë paraardhësit, të kaluarën që nuk qe e mirë me ne, që na dënojnë me komunizëm ndërsa treni i vendeve vrullon përpara.

Faktorët e prodhimit si burimet natyrore (toka) burimet njerzore, kapitalet e ndjenja e sipërmarrjes dhe aftësit krijuese të njerzëve tanë janë tepër të shëndetëshme për të realizuar zhvillimin e duhur po të drejtohen e orjentothen në mënyrë racionale e me optimum. Optimalizimi i përdorimit të resurseve e faktorve nuk mund të bëhet nga "grupet folklorike" të politikës por nga epike kombetare specialistësh dhe vizionarësh më dituri e eksperiencë, dëshirë të mirë, vizione të qarta e realiste, të përgjegjshëm në sipërmarrjen e tyre për projektimin e zhvillimin e integrimin e vendit.

Kërko e rëndit faktorët e zhvillimit të vendit.... Nuk është fjala të bëjmë analiza të ngushta kostosh prodhi për produkte të caktuara, por një analizë diakronike të zhvillimit të vendit në këtë periudhë të stërgjatur të tranzicionit, ku politikanët tanë vazhdojnë të përdorin ende "zarfin e parë", atë justifikimit me prapsitë e paafhtësit e paraardhësve dhe se ato nuk ndjehen fajtor sepse po përpiqen, por punet këtu kanë qenë aq keq.... Kush e dreqosi fillin tonë të ristrukturimit e të reformimit të ekonomisë sonë kombetare, kush i dha "shok" ndërkohë që ajo kishte nevoj për mjekim se pse nuk ishte aq rëndë sa e paraqiten ideollogetë e të keqës sonë...., kush e nxitte revolucionin: "prishni kullat të ndërtojmë kasolla.....", kush i injoroi dhe defaktorizoj kapacitetet, aftësitë e përvojat e një brezi njerzorë, të krijuar e kualifikuar, për mes punës e shkollimit si vlerë e fuqisë kombetare që garantonte zhvillim të sigurtë, por që u detyrua nga politikat e mbrapshta, të referuara në qëllime të këqija, të ndahen nga burimet e tokës së tyre, për të kërkuar mbijetesën si argat, duke e shëndrruar të gjithë popullin në konsumatorë të produkteve të fqinjëve të tij ballkanik, duke shformuar e deformuar shpërdarjen e popullsisë, duke braktisur e lënë të ngrira rezultatet tona natyrore, që të kishin mundësi të vinin cakejntë e minjerave të skallavronin të gjithë minatorët eë metalurgët shqiptarë.... Ky ishte fillimi ynë i keq, që na la edhe një gjysëm udhe më larg.. Fillimi i mbarë gjysma e punës, por kur e fillon keq ka rrezik të mos e kryesh fare punën.. Ne ende vazhdojmë të përballojmë pasojat e fillimit të keq....

Bajram Mata qe një piktor gjenial, që e pati jetën të shkurtër dhe të mbushur me plot peripeci

Nga: XHAFFER MARTINI

Për shumëkënd i paharruari Bajram Mata sot mund të jetë harruar. Bajram Mata qe një piktor gjenial që e pati jetën të shkurtër dhe të mbushur me plot peripeci. Fjala "gjenial" është tamam në vendin e duhur dhe nuk ka në të asnjë lloj teprimi. Por kjo fjalë, në këtë rast, përdoret në kuptimin e potencialit krijues, si mundësi për të arritur gjenialitetin. Bajrami nuk arriti t' i kthente premiset e jashtëzakonshme në vepra arti për dy arsye: e para, se e pati jetën të shkurtër; e dyta, edhe sa ishte gjallë, ai krijoi pak, pa përfunduar dot metodën e realizmit socialist, pa përfunduar dot jetën, që e deshi të ishte ndryshe nga c' ishte. Në diktaturë të gjithë ishin të lidhur me shtetin. Tentakulat e tij i kishin mbërthyer të gjithë, edhe artistët. Shtetit të diktaturës i përshtatet thënia e Niçes se: "Shtet unë quaj shoqërinë ku të gjithë janë ngopur me helm... në shtet vetëvraska graduale e të gjithëve, na quhet jetë." Në atë kohë, si dihet, sundonte mediokriteti. Njerëzit zinin poste drejtuese vetëm në saj të përkrahjes partiake, pa pasur asnjë cilësi dhe zotësi personale. Kjo natyrë sunduese e bëri mediokritetin modë, model, të pëlqyeshëm, të përshtatshëm për t' u ndjekur dhe dalëngadalë u krijua një kope njerëzore, si thotë Nice, që është e prirur drejt qetësisë dhe rehatisë ashtu si i kupton ajo këto. Bajram Mata, duke qenë i pajisur me cilësitë e gjenit, nuk kishte vend në atë shoqëri, në qoftë se nuk i përshtatej asaj. Sepse, po të perifrazojmë edhe një herë Nicen, tendenca e të dobtëve dhe mediokrëve në të gjitha kohërat ka qenë t' i bëjnë të fortët të dobët, t' i nënshtrojnë ata që t' i barazojnë me veten, madje t' i zbrisin edhe në nivelin e tyre. Për këtë qëllim ata kanë një armë: gjykimin moral. i akuzojnë dhe i damkosin gjenitë që nuk ecin në rrugën e duhur, që nuk janë kafshë të kopesë së bindur; i akuzojnë se ata duan të krijojnë një tip më të lartë njeriu.

Në këtë shkrim nuk kam për qëllim të analizoj nga pikëpamja artistike veprat e Bajram Matës. Kjo është detyrë e kritikëve të artit. Ky shkrim më shumë është një homazh për Bajram Matën, i cili ka më shumë se tri dekada që ka vdekur dhe nuk është kujtuar kurrë, asgjë nuk është bërë për të. Me këtë shkrim unë kam qëllim që të sensibilizoj opinionin artistik që t' i rikthehet Bajram Matës se ishte një piktor shumë i talentuar. Me këtë shkrim dua t' u them njerëzve, sidomos brezit të ri, se ka pasur një piktor shumë të shquar, që quhej Bajram Mata, t' i them familjes që të ndihet krenare, por edhe borxhlie ndaj tij, t' u them shokëve e miqve të Bajram Matës që të gjejnë mënyrën për ta kujtuar këtë njeri të madh në kuptimin më të plotë të fjalës.

Me Bajram Matën kam pasur nderin të kem qenë në një klasë në shkollën shtatëvjeçare "Demir Gashi" të Peshkopisë. Madje e kam pas shok banke. Më kujtohet një orë vizatimi. Do të vizatonim, më duket, një gotë, që mësuesi na e vuri tek tryeza e vet. Ishte një mësues që merrte vesh nga piktura. Bëmë sa mundëm dhe si



"Dimër në Bulqizë".
Pikturë nga Bajram Mata.

Homazh për Bajram Matën

ditëm. Unë e bëra gotën me përpikëri, e vizatova saktë, me dritë, me hije, sipas udhëzimeve të mësuesit. Bajrami hodhi ca vija në letër, që mua nuk më dukeshin se kishin të bënin me gotën, por, kur erdhi vlerësimi, ai mori notën më të lartë, kurse unë një notë më të ultë. Nuk i thashë gjë mësuesit, por ai e kuptoi që më mbeti hatri dhe më tha:

- Ty të duket që Bajrami ka bërë ca viza, por edhe vizat tek ky hedhin valle.

Më ndejtën në mëndje shumë kohë fjalët e mësuesit. Me kalimin e viteve, sa më shumë dhe më mirë formohesha artistikisht, aq më shumë kuptoja se ato nuk ishin viza që i kishte kapur ngërçi, nuk ishin segmente të atrofizuara, por si sh-tjella resh, si ato gjeratoret gjigande që formojnë dallgët e detit në gjire, kur ujët përplasen pas shkëmbenjtve. Tani unë gjykoj që në ato viza kish-te një frymë lirie, hapësirë, horizont, prej tyre vinte një mendim dhe një ndjenjë e tjetërsojshme. Bajrami nuk u kuptua nga unë aso kohe dhe kjo ishte e natyrshme, por ai nuk u kuptua asnjëherë, sa qe gjallë, prej bashkëkohësve. Sipas metodës së realizmit socialist, do të thoshte të krijoje vepra të dobishme, që t' i shërbenin sistemit dhe t' i përshtateshin atij. Krijuesit, përgjithësisht, ishin kthyer në njerëz të dobishëm, "në ndihmë të partisë për edukimin e masave". Bajrami nuk ishte i tillë, gjenitë nuk janë njerëz të dobishëm. Prandaj, kur krahasohej me krijuesit e tjerë, ai dukej si "jashtë lojë". Por

Ky shkrim më shumë është një homazh për Bajram Matën, i cili ka më shumë se tri dekada që ka vdekur dhe nuk është kujtuar kurrë, asgjë nuk është bërë për të. Me këtë shkrim unë kam qëllim që të sensibilizoj opinionin artistik që t' i rikthehet Bajram Matës se ishte një piktor shumë i talentuar. Me këtë shkrim dua t' u them njerëzve, sidomos brezit të ri, se ka pasur një piktor shumë të shquar, që quhej Bajram Mata, t' i them familjes që të ndihet krenare, por edhe borxhlie ndaj tij, t' u them shokëve e miqve të Bajram Matës që të gjejnë mënyrën për ta kujtuar këtë njeri të madh në kuptimin më të plotë të fjalës.

Artur Shopenhauer thotë: "Të krahasosh personat e dobishëm me personat gjenialë, është si të krahasosh gurët e ndërtimit me diamantët."

Si mbaruam shtatëvjeçaren, na ndau rrjedha e jetës: unë vijova shkollën pedagogjike në Peshkopë, kurse Bajrami liceun artistik "Jordan Misja" në Tiranë. Bajrami në lice shkëlqeu dhe, mbas mbarimit të tij, iu dha e drejta të studioje për pikturë në Bashkimin Sovjetik. Në këtë vend të madh, me pejazhe të mrekullueshme dhe të larmishme, me një traditë të lashtë dhe të famshme kulturore e artistike, ai pati kontakte me mjeshtër të mëdhenj të pikturës, pedagogë dhe akademikë, si dhe me piktorë të tjerë të talentuar që vinin nga shumë vende dhe që sillnin me vete jo vetëm psikologjinë dhe identitetin kombëtar, por edhe koloritin kombëtar, qëndrimin estetik ndaj realitetit. Në këtë vend Bajrami u njoh me galeri dhe muze të mrekullueshëm, ku ruheshin dhe ekspozoheshin veprat e mjeshtërve më të mëdhenj të botës. Bajrami qëndroi një vit në BS se marrëdhënit e ndërshtetërore u prishën. Megjithatë, në vetëdijen e tij u formuan shumë shtresa kulturore; ai mësoi mirë rusishten, dhe u dashurua jo vetëm pas pikturës, por me artin dhe letërsinë në përgjithësi. Ai kishte shumë libra në gjuhën ruse, kryesisht poetë, poezitë e disa prej tyre, sidomos të Ezeninit, i dinte përmendësh dhe i recitonte me pasion. Bajrami ishte lindur në një familje Gollobordase që si gjuhë të nënës kishin një

dialekt të rrëguar sllav, më duket më i afërt me bullgarishten. Duke pasur këtë prejardhje, ai thithi shumë nga shpirti rus, dhe e pa Rusinë më shumë sesa një vend ku kishte shkuar për të kryer studimet. Bashkëstudentët e tij shqiptarë tregojnë se Bajrami gëzonte një nderim të veçantë tek pedagogët dhe profesorët rusë, sepse ai ishte i veçantë si piktor. Pasi u kthye në Shqipëri, ai i plotësoi studimet në Akademinë tonë të Arteve në Tiranë. Si mbaroi atë, Bajram Matën e sollën mësues vizatimi në Peshkopë. Djaloshi i bukur, elegant, truplart dhe trupdrejt, syzi e vetullzi, me një vështrim si prej shqiponje, por të ëmbël dhe dashuripërçues; kishte flokë të zes dhe të bukur, me një valëzim të lehtë si ato vijat mjeshtrërore që i hidhte me penel piktori. Vishej bukur dhe me pamjen e tij djaloshare tërhiqte vëmendjen e të gjithëve. Mbi të gjitha ai ishte i veçantë në sjellje, në qëndrime, mendime dhe veprime. Ishte disident shpirtëror, ai nuk pajtohej me sistemin në asgjë, nuk pranonte asnjë hallkë të tij. Disidencën e tij unë e shikoja në veprat e tij. Nuk mund të ecte kundër rrymës dhe nuk krijoi, me sa di, vepra në kundërshtim me frymën sunduese. Por në veprat e Bajramit kishte shumë ngjyra, shumë dritë, shumë gjelbërim, ujëra dhe njomësi, bar të njomë, lule, gjethe, urth, shelgje, mështekna, sa shumë mështekna! Kjo, sidomos, në pejazhet. Ai e kuptonte që jeta ishte e thatë, pa gjelbërim, pa oksigjen. Dhe të gjitha këto i shprehte dhe i përjetonte në krijimtarinë e tij. Bajrami përgjithësisht ishte tip i mbyllur, nuk kishte shumë shok. Edhe kjo fliste për gjenialitetin e tij, sepse, po t' i drejtohem edhe një herë Shopenhauerit, do të mësojmë se "Gjeniu është kryesisht i vetmuar. Ai është tepër i rrallë për të mundur të gjejë, të takojë lehtësisht një të ngjashëm me veten, dhe, njëkohësisht, shumë i ndryshëm nga të tjerët për të mundur të bëhet shok me ta."

* * *

Emërimi si mësues vizatimi në Peshkopë qe goditja e parë që ai mori nga sistemi. Po të kishte qëndruar në Tiranë, ku kishte tjetër frymë dhe atmosferë krijuese, ai mund të kish-

te punuar shumë dhe jeta e tij mund të kishte marrë një drejtim tjetër. Peshkopia ishte një qytet provincial, me një mentalitet provincial, ku sundonte mediokriteti. Cilësia e parë e Bajramit ishte mospërshtatja. Ose më mirë është të thuhet se mospërshtatja ishte në natyrën e tij, me çka duhet kuptuar se mospërshtatja ishte vetë ekzistenca e tij. Ai nuk dinte të përshtatej, ai nuk e merrte parasysh aspak mjedisin ku jetonte. Por, që të mos përshtatesh, do të thotë të mos mbijetosh. Njeriu është edhe qenie biologjike. Bajram Mata kishte një shpirt të pasur dhe të pastër. Filloi të bënte shok gotën e alkoolit. Orë euforike, në hapësirat që ai i ëndërronte, pastaj, prapë zhytej në fundin e gotës, të asaj gotës së vogël, ku janë mbytur njerëz të mëdhenj.

Bajram Mata ishte njeri i admirueshëm. Kishte një humor shumë fin, shumë elegant. Ishte krijues i aforizmave. Njeriu ndiente kënaqësi kur bisedonte me të, sidomos në ato vitet e para, kur shpirti i tij ende nuk ishte plagosur.

Si mësues ka dhënë një kontribut të madh, sidomos na zbulimin e talenteve të reja në fushën e pikturës. Vështrimi gjithëpërfshirës të Bajramit nuk i shpëtonte asgjë. Tregon vajta ime, Elsa, sot piktoje: "E kisha mësues vizatimi në klasën e gjashtë në shkollën tetëvjeçare "Irfan Hajrullai". Nxënësit i luteshin "t' ua drejtonte pak" vizatimin që kishin nisur. Ai shkante tek secili, bënte disa vija që vetëm ai dinte t' i bënte ashtu. Erdhi edhe tek unë. Tani, tha, po merrem pak me Elsen, se kjo do të merret gjithë jetën me këtë punë. Kapi lapsin dhe bëri disa korrigjime e plotësime. Deri atëherë nuk kisha pasur as idenë që mund të merrsha me pikturë."

Bajrami ishte njeri shumë i ndjeshëm, shumë i sinqertë dhe i dashur. Ai nuk e duronte dot meskinitetin sundues të asaj kohe, dhe vuante shumë nga mungesa e lirisë së krijimit. Ata që i kanë jetuar ato vite, e dinë mirë se si pranoheshin punët në ekspozita, në sa komisione kalonin, sa hallka duhej të kapërcenin për t' u aprovuar, sa marrëzi duhej të dëgjonin piktorët për t' i ripunuar veprat dhe për t' i bërë të përshtatshme për ekspozim. Bajrami nuk e donte veten kur lloj - lloj instruktorësh dhe zyrtarësh i shkonin në studio për t' i parë veprën dhe për t' i bërë vërejtje, se çdo vërejtje e tyre ishte për të qeshur dhe për të qarë njëkohësisht. Këto ishin orë jo vetëm të humbura kot, por edhe e trondisnin shpirtërisht. Nuk gjente askund ngushëllim, vetëm tek gota. Bajrami nuk diskutonte me këta njerëz, i linte të llapnin, pastaj vazhdonte të pikturonte ashtu si dinte ai. Nuk ka gjë më të ulët se sa njerëzit mediokër të diskutojnë me një gjeni për artin e këtij të fundit. Kjo nuk mund të bëhet as nga elementët e talentuar, jo më nga mediokrit, sepse gjeniu qëndron shumë lart dhe shumë larg edhe nga elementët shumë të talentuar. "Talenti, - thotë Shopenhaueri, - është i ngjashëm me qitësin që qëllon në shenjë, të cilën të tjerët nuk mund ta arrijnë. Gjeniu është i ngjashëm me atë që qëllon në shenjë, të cilën të tjerët as nuk arrijnë ta shohin..." (Vijon numrin e ardhshëm)


Biri i Dibrës së vlerave të mëdha kulturore

Nga: **HAMDI HYSUKA**

Në historinë e kulturës e të artit kanë spikatur artistë, krijimtaria e të cilëve ka pasuruar dhe zbukuruar qytetërimin njerëzor. Jeta dhe krijimtaria e tyre është një jetë pune, plot dashuri, vuajtje e vetmohim. Midis kësaj plejade artistësh bën pjesë kompozitori Mynir Shehu. Vitet e ndarjes nga jeta mjaftojnë për të treguar se sa i paharruar është dhe çfarë vlerash ruan për kohën e sotme.

Myniri u lind në qytetin e Peshkopisë nga një familje me tradita. Megjithëse me funksionin fetar sheh, babai i tij mori pjesë në lufrat e Dibrës kundër serbëve. E ëma ishte bija e patriotit të njohur Bej Zajmi, mik i ngushtë i Abdyl Frashërit. Në këtë familje u rrit dhe u edukua Myniri me motrat e vëllezërit e tij. Pas mbarimit të shkollës fillore në Peshkopi, iu dha e drejta për të vazhduar Normalen e Elbasanit, ku shpejt ra në sy intelijenca e tij në mes të shokëve nga trevat e Shqipërisë. Duke qenë intelektual dhe me një kujtesë të fortë, ai dallohet në të gjitha lëndët, sidomos në gjuhësi. Në shkollë mësoi me themel italishten, frengjishten dhe luante në mënyrë të përsosur në violinë. Si nxënës i mësuesit të shquar Aleksandër Xhuvani, Ahmet Gashi e Simon Shuteriqi, filloi të gërmojë në histori dhe studioi pa pushuar filozofi. Pas përfundimit të shkollës Normale të Elbasanit, në vitin 1932, emërohet mësues në fshatin Herbel të Peshkopisë dhe në disa fshatra të tjera të prefekturës së Dibrës. Pas pushtimit fashist shkoi për studime në Itali, por kthehet shpejt për shkak të pikpamjeve të tij. Pushtuesit italianë e pushojnë nga puna dhe e transferojnë në Shkodër. Më pas emërohet inspektor kulture në prefekturën e Dibrës së Madhe. Në të gjitha fshatrat ku shkonte, ai takonte pleqtë dhe merre prej tyre këngët e lashta të krahinës. Ndërkaq shkruan vargje dhe kompozon këngë të ndryshme. Shkruan një roman, përkthen nga frengjishtja, studion e studion.

Nga viti 1932 e deri në vitin 1945 brend fshat më fshat dhe varr në varr, mbledh emrat e anëtarëve të familjes Shehu të Peshkopisë dhe përpilon pemën gjenealogjike të fisit, nga themelimi në vitin 1602 e deri në brezat e fundit. Mynir Shehu nuk mori pjesë në luftë, por shtëpia e tij ishte bazë për të gjithë patriotët e të cilës anë ishin. Provoji burgun, amnistohet, por nuk e lirojnë. Pas daljes nga burgu, për shkak të nevojave të rrethit dhe duke ia njohur aftësitë, emërohet mësues në shkollën 8-vjeçare, përgjegjës i shtëpisë së kulturës dhe mësues muzike në pedagogjikën e Peshkopisë. Kudo ai punoi me pasion dhe me këmbënguljen që e karakterizonte. Ndonëse i sëmure nga jeta e rëndë nëpër burgje, pa shtëpi, Myniri kompozoi këngë, të cilat i këndon gjithë Dibra. Ato këndohen dhe në Kosovë e Maqedoni. Brenda pak vitesh shtëpia e kulturës në Peshkopi bëhet me orkestrë nga instrumentistët që ai vetë kishte përgatitur. Po ashtu edhe shkolla pedagogjike krijoi orkestrën e vet, grupin e këngëve e valleve, të cilat vazhdimisht furnizuan shtëpinë e kulturës me instrumentistë, këngëtarë e valltarë. Në këtë periudhë jeta kulturore në qytet arrin kulmin. Pas vitit 1963 Mynir Shehu transferohet në Burrel. I lodhur, i deziluzionuar, përsëri punon, pa hequr dorë nga profesioni i tij. Fillon punë në shkollën "31 korriku" dhe përgjegjës muzike në shtëpinë e kulturës. Edhe këtu krijoi orkestrën e shtëpisë së kulturës së rrethit, studioi e grumbulloi folklorin dhe e vuri atë në skenë. Krijoi këngë e melodi sipas folklorit matjan, me të cilat u përfaqësua rrethi i Matit në festivale e para folklorike e më pas në ato të Gjirokastrës. Në njerin nga këto festivale, melodia e kompozuar prej tij dhe e interpretuar nga orkestrina popullore e Matit, u cilësua sinfoni matjane. Por meqenëse trajtohej me biografi të keqe, autorësia e tij nuk u publikua. Kjo e vrau shumë në shpirt, e theu moralisht dhe nuk mori pjesë më në përgatitjet për festivale e tjera folklorike kombëtare, edhe pse vinin dhe e kërkonin. Si folklorist ka marrë pjesë në Konferencën Kombëtare të Folklorit më 1972. Para Mynir Shehut në Burrel kishte punuar në



sektorin e kulturës muzikanti popullor tiranas Skënder Frashëri, i cili la disa këngë popullore shumë të bukura. Por vetëm kaq. Atij i mungonte njohja e folklorit, se treva e tij nga vinte nuk kishte ngjashmëri.

Mati, vend me histori e kulturë të lashtë, popull me shpirt të madh e krenar, me një folklor aq të pasur, përse i përket fushës së kulturës, ndodhej ndër vendet e fundit. I takoi Mynir Shehut që, për një periudhë të shkurtër, ta ngjite në majat e artit popullor shqiptar. Gjithë periudha e punës së tij është periudhë arritjesh e suksesesh. Me ardhjen e Mynir Shehut Mati arriti të shpalojë vlerat e vërteta dhe të zinte vendin e merituar në panteonin e kulturës popullore.

I biri, Mirdashi, nuk rri dot pa përmendur faktin se ish-sekretar i parë i asaj kohe, Mustafa Pajenga, e çmonte shumë, duke e quajtur "profesor", jo për modë, po për kulturën që kishte, moshën dhe sidomos punën e përkryer që bënte në shtëpinë e kulturës.

Mynir Shehu ka kompozuar shumë këngë, disa prej të cilave kanë hyrë në fondin e artit të këngës popullore si "Cuca e Radomirës", "Bulqizakja", "Katundarja në katund të ri", "Liqeni i Ulzës" etj. Kënga e Liqenit të Ulzës, kënduar nga Feride Kurti në festivalin folklorik kombëtar të Elbasanit më 1966, u bë biss 112 herë. Gjatë netëve u përvetësua shpejt nga dëgjuesit dhe u cilësua si kënga më e mirë e festivalit.

Brezat që vinë për ta çuar përpara artin dhe kulturën popullore matjane e kanë një bazë nga ku mund të nisën, e kanë një përvojë, një arritje, të cilën mund ta çojnë më përpara. Ata, që në kundërshtim me realitetin artistik, duan të marrin role që nuk u takojnë, të dobësojnë vlerat, harrojnë se i shkaktojnë dëm të madh së pari Matit, pasi vlera nuk humbet. Vlera i ngjan drurit, që sa më gjatë të shkojë, aq më shumë stazhionohet, aq më i fortë bëhet.

Mynir Shehu la pas krijimtarinë e tij. Dhimbje e krenari ndjen për jetën e tij. Atë e karakterizonte korrektësia, talenti, vullneti e serioziteti në punë. Mbetet i paharruar jo vetëm për të afërmit, por dhe për ish-nxënësit e tij, për kolegët dhe gjithë të dashurit, në mënyrë të veçantë për artdashësit e shumë të Dibrës, Mat dhe anëmbanë Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë.

Mati nuk mund ta harrojë Mynir Shehun, birin e Dibrës së vlerave të mëdha kulturore, një ndër krijuesit më të zë të muzikës popullore.

Mati nuk mund ta harrojë Mynir Shehun, birin e Dibrës së vlerave të mëdha kulturore, një ndër krijuesit më të zë të muzikës popullore.

Shkolla e Pezë Helmësit kujton me mall Nderimen...

A tëherë ishte pranverë. Lu-let kishin çelur e simfonia e bukur e Azogjve ishte e pranishme kudo. Nxënës e mësues të shkollës Pezë Helmës ishin mbledhur në oborrin e shkollës e me kurora me lule në duar e lot në sy u nisën për t'i dhënë lamtumirën e fundit mësueses dhe koleges së tyre Nderime Methasani e cila ishte ndarë nga jeta në moshë të re. Kanë kaluar nëntë vite që atëherë e kujtimi për mësuese Nderimen nuk është lehtë të shlyhet nga kujtesa për ato që e kanë njohur nga afër. Sa herë vjen shtatori e oborret e shkollave gumëzhijnë nga nxënësit shkolla e vogël në Pezë Helmës me mësues e nxënës ende e kujtojnë me mallë mësuesen dhe kolegen e tyre Nderime Methasani. Emri i saj figuron kudo në shkollën e Pezë Helmësit. Shumë ish nxënës të saj mbajnë deftesat të shkruar bukur e pastër e në fund emir i Nderime Methasani si mësuese kujdestare. Në arkivin e shkollës domosdo që ndodhen rregjistrat ku me shije e një shkrim të qartë ka hedhur mungesat, notat e pse jo dhe sjelljen e nxënësve të saj. Ajo ndërroi jetë në moshën më të mirë, kur jo vetëm prindërit, vëllezërit e motrat por dhe kolektivit mësues nxënës priste më shumë nga Nderime Methasani, kjo bijë e Sohodollit, e lindur dhe e rritur në një familje intelektuale. Puna e saj për disa vite me radhë në Pezë Helmës tregoi qartë për shpirtin pasionant të mësueses të përkushtuar.

Respekti për kolegët dhe nxënësit bënë që edhe pse kanë kaluar kaq vite që nuk jeton më midis nesh të kujtohet nga të gjithë. Ajo la gjurmë që nuk shlyhen lehtë në kujtesën e të gjithëve, me sjelljet dhe vrytytet më të mira që e karakterizonin ua imponoi respektin të gjithëve. Nxënësit e saj atë ditë të zezë që morën vesh se mësuesja e tyre nuk do të vinte më në mëngjez herët në shkollë si çdo ditë tjetër hidhërimin e derdhën në poezi. Poezi malli për mësuesen e tyre të dashur që nuk do ta harrojnë kurrë:
"Rininë i fale fshatit,
shkollës dashurinë,
neve dhuratë brengën
pranverës dhuratë zinë..."



Si në të gjitha shkollat e vendit edhe në Pezë Helmës mësimi ka filluar. Imazhi i mirë i mësuese Nderime Methasani është kudo nëpër klasa, në koridore, në oborr, në mendjet e zemrat e atyre që e kanë njohur

Janë plot tetë strofa të shkruar bukur e gjithë dhimbje nga ish nxënësit e Pezë Helmësit të vitit 2000 kur nuk e panë më mësuesen Nderime Methasani. Nuk ka më dhuratë e nderim më të madh që i bëjnë edhe sot pas kaq vitesh. Kujtime, lule e poezi. Kujtimet zgjojnë krenarinë për mësuesen e paharruar, poezitë shprehin mallin dhe dashurinë që kanë patur për të. Nderimja u nda nga jeta në pranverën e viti 2000 ku atëherë sapo kishin filluar të çelin lulet e cicërimat e zogjve ishin të pranishme kudo. Edhe sivjet erdhi shtatori. Si në të gjitha shkollat e vendit edhe në Pezë Helmës mësimi ka filluar. Imazhi i mirë i mësuese Nderime Methasani është kudo nëpër klasa, në koridore, në oborr, në mendjet e zemrat e atyre që e kanë njohur.
/ Sh. Skarra




"Infini Plus" Paskuqan

Tel. 0682080517

- Jeni në kërkim të një apartamenti banimi tepër komod e në një vend të bukur relaksi?
- Kërkoni zyra apo lokale?
- Ju nevojiten njësi tregtare apo mjedise për banka?
- Ju duhet ndonjë ambient i posaçëm për klinika mjekësore?
- Doni lokale për dasma apo mjedise të tjera me sipërfaqe të mëdha për shërbime të ndryshme?
- Doni shërbime të klasit të parë?

Mjaft jeni lodhur duke kërkuar. Të gjitha këto ua siguron vetëm Infini Plus.

- Kompleksi "Infini Plus" i pari i këtij lloji në zonën e Paskuqanit tashmë është në prag të përfundimit.
- Kompleksi "Infini Plus" është një kompleks modern i pari i këtij standardi.
- Kompleksi i pari dhe i vetëm në llojin e tij sepse afron të gjitha kushtet optimale për një shërbim me të gjitha avantazhet që nevojiten.
- Avantazhi kryesor është se do të afrojnë një nyje kryesore për të gjitha shërbimet në zonë.
- Afron një sipërfaqe prej 5000 metra katror ambiente shërbimi e konceptuar në katër kate që do të përfshijë në të gjithë zonën me dhjetëra njësi tregtare, zyra përfaqësie, klinika mjekësore, shërbime bankare, biznese dhe shërbime të klasit të parë.
- Afron hyrje 1 + 1 me 70 metra katror, 2 + 1 me 98 metra katror dhe 3 + 1 me 100 metra katror.
- Çmimi 450 euro për metër katror më lirë në të gjithë tregun e ndërtimeve të apartamenteve.
- Afron ambiente relative dhe hapësirë të gjelbër prej 4000 metra katror.
- Afron hapësirë të mjaftueshme për parking prej 140 vendesh.
- Kompleksi përshkohet nga dy rrugë: Rruga "Siri Kodra" dhe rruga "Jordan Misja"
- Në krah të kompleksit do të kalojë Unaza e Madhe, një nga arteriet kryesore të Tiranës.



Mos u lodhni duke kërkuar. Ne nuk zhgënjëjmë njeri, pasi vazhdimisht kemi konkuruar me cilësi dhe standarde të larta

Telefon:
068 20 80 517.